

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7823 E diel 17 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**

**Nga RIGELS LENJA**

### Rreziku që vjen nga islamofobia

Pa diskutim që 11 shtatori është "festivali më i madh i terrorit", që pati së paku dy pasoja direkte mbi mbarë njerëzimin. Së pari, superfuqia më e madhe e botës ...

Vijon në faqen 21

**Opinion** **Ditës**

**Nga ANDI BUSHATI**

### Rama nuk ra, por u fsheh pas gazit lotsjellës

Nëse opozita dështoi në premtimin e gënjeshtërt që u bëri ndjekësve të saj, se 16 marsi do të ishte dita e fundit e Edi Ramës, ajo është në rrugë të mbarë për të ...

Vijon në faqen 22



Haxhi Baxhinovski, i dënuar për "Qafë-Barin"

## Ish-i përndjekuri politik ekzekutohet me armë te Liqeni në sy të djalit të vet

62-vjeçari qëllohet në pedonalen e kodrave të liqenit në Tiranë. Dyshimi, konflikt i hershëm

Një atentat ndodhi mbrëmë në Tiranë në zonën e Liqenit Artificial, ku dy persona me maska vranë me armë zjarri 62-vjeçarën Haxhi Baxhinovski në sy të djalit të tij të mitur. Ky i fundit ishte duke vrarur te kodrat e liqenit bashkë me djalin e tij të mitur kur dy personat i janë afruar dhe e kanë qëlluar për vdekje, ndërsa i biri, por edhe kalimtarë ...

Në faqen 7

## PERLESHJE PARA KUVENDIT/ BASHA: QEVERIA E HAJDUTEVE, PARA DREJTESISË

# OPOZITA NE RRUGE, PLAGOSEN 12 PROTESTUES DHE POLICE

Tension në Tiranë, përplasje me gurë dhe gaz lotsjellës. Kryemadhi: Loja ka filluar të luhet fort. Sandër Lleshaj: Keqardhje për degradimin e opozitës



(Në foto) Kryetari i PD, Lulzim Basha, gjatë një proteste përpara Kryeministritë

Në faqen 2-4

### PROTESTA PD-LSI

**Rama në Berat: S'ka shans të rrëzohet qeveria e votuar nga shqiptarët**

Në faqen 5

### FAQET KULTURORE

**Sot në "Milosao"/ Historianët polakë: Ju rrëfejme Ndre Mjedën në Krakov**

Suplement

### SHIFRAT ZYRTARE

**74 mijë gjopa për parkim të gabuar gjatë vitit 2018 në qytetin e Tiranës**

Në faqen 6

### LISTA EMERORE

**6 mijë dosjet e pronave që iu është njohur fatura financiare**

Në faqen 10

### ANALIZA



**Ksenofon Krisafi: "Paraja, bankat dhe shoqëria", një libër me vlera të spikatura**

Në faqen 11

Dosjet e patrajtuara, procedura për tërheqjen e dokumenteve për në gjykatë

## ATP, grafik me takime për ankesat e pronarëve

Publikohet formulari që duhet të plotësojnë përfituesit e kompensimit

Pronarët që kanë marrë një vendim për njohjen dhe kompensimin e pronës dhe duan një informacion në lidhje me procedurën që do të ndiqet për kompensim mund të marrin informacion pranë Agjencisë së Trajtitimit të Pronave, pasi të kenë plotësuar një formular-tip. Agjencia



bën të ditur se të gjithë të interesuarit që kërkojnë takim apo kanë një ankesë, mund ta bëjnë këtë me shkrim, ose duke plotësuar formularin. "Orari i ofrimit të shërbimeve është nga e hëna në të enjte, ora 08.00 deri në 14.00 dhe të premtën ...

Në faqen 6

## PROTESTA PËRPLASJA

### LUAN BAÇI

Kreu i PD-së në Fier, Luan Baçi, i shoqëruar bashkë me të birin - doli nga ambientet e komisariatit. "Po hotohem në gjendje të lirë për kundërshtim të punonjësve të policisë. U ndalua në Unazë ndërsa po udhëtonim drejt Fierit. Djalin ma kanë rrahur vetëm se nxori telefonin dhe nisi të filmojë veprimet arbitrare të policisë. Shumë qytetarë fierakë janë shoqëruar pa arsye", tha Baçi.



Ish-deputetët, me të plagosurit: Dhunë mbi protestuesit, fraktura e humbje shikimi

Valentina Madani

Tensionet e protestës së opozitës para godinës së parlamentit përgjatë 4 orëve patën një bilanc me disa të lënduar. Përdorimi masiv i gazit lotsjellës nga policia si e vetmja mënyrë për të larguar turmën, e cila sulmoi me gurë godinën e Kuvendit u ka shkaktuar probleme me frymëmarrjen një pjesë të konsiderueshme protestuesish. Të vetmit që shpëtuan nga gazi lotsjellës ishin policët dhe disa gazetarë, të cilët kishin marrë masat për një situatë të tillë. Por uniformat blu nuk u shpëtuan lëndimeve nga përlëshjet fizike dhe hedhjeve drejt tyre të gurëve dhe e sendeve të forta. Gjithashtu, për të shpërndarë turmën forcat e rendit kanë përdorur edhe ujë.

### POLICIA

Policia e Shtetit reagoi dje pas protestës së opozitës, ku evidenton faktin që zhvendosja nga Kryeministria të parlamenti ishte në kundërshtim të plotë me ligjin, pasi nuk ishte theksuar ky itinerar në kërkesën që opozita kishte bërë në polici për lejen e tubimit. Sipas njoftimit për mediat, bëhet me dije se nga tensionet mes protestuesve, tre efektive të policisë kanë mbetur të lënduar. Gjithashtu, në reagimin e saj policia thekson se të lënduar pati edhe persona mes tubuesve, për shkak të hedhjes së gazit në momentin kur turmat çau kordonin e policisë. "Partia Demokratike e aleatët e saj organizuan një tubim në bulevardin 'Dëshmorët e Kombit', i cili në kundërshtim të plotë me ligjin, në mënyrë të papritur dhe të pa lajmëruar, por edhe në kundërshtim me vetë kërkesën e organizatorëve për vendin e protestës, u zhvendos në sheshin para Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë tubimit të paligjshëm përpara Kuvendit, protestuesit krijuan incidente me policinë dhe më pas e goditën, gjatë përpjekjes për të çarë kordonin e forcave të rendit. Mbi punonjësit e Policisë së Shtetit u hodhën gurë dhe

# Protesta, shoqërohen 20 persona, mes tyre ish-deputeti me djalin

*Policia: Tubimi i paligjshëm, protestuesit krijuan incidente*



### META: EVITONI KONFRONTIMET

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, apelojoi dje për protesta paqësore. Në një mesazh, ai bëri thirrje për evitim të konfrontimeve. "Presidenti i Republikës është duke ndjekur me shqetësim situatën. Ai bëri thirrje për demonstrim paqësor dhe ruajtje të qetësisë. Ai u kërkoi të gjithëve të evitojnë konfrontimet dhe të qëndrojnë larg provokimeve", tha z. Meta.

kanë shkuar ish-deputetët e PD-së, Ervin Salianji dhe Enkelejd Alibeaj". Ish-deputetët e Partisë Demokratike, pas mbylljes së protestës së djeshme ku u shënuan edhe disa incidente para Kuvendit, shkuan në spital për të vizituar protestuesit e lënduar. Ish-deputetja Albana Vokshi, Bardh Spahia dhe Tritan Shehu vizituan disa prej protestuesve në spital. Sipas PD-së, njeri prej tyre është Eduard Shosha, 50 vjeç. Ai ka dy brinjë të thyera nga goditja me ujë me presion, e cila e ka përplasar në bordurë. Ndërkohë më herët ishte ish-deputeti Luçiano Boçi që shkoi në spital pranë disa qytetarëve që mbetën të lënduar në protestën që opozita mbajti sot përrreth 4 orë. Përmes një statusi në "Facebook", Boçi shkruan se brutaliteti i policisë, me përdorimin e lëndëve helmuese mbi protestuesit ka sjellë dëmtime serioze për ta. "Brutaliteti i policisë, me përdorimin e lëndëve helmuese mbi protestuesit ka sjellë dëmtime serioze për ta. Junta ushtarako-policore e Ramës ka ushtruar dhunë dhe ka goditur qytetarët. Kodhel Çala është sulmuar nga afër me pistoletë lëndëdhënëse, drejt e në sy. Ka humbje shikimi dhe komplikacione në frymëmarrje. Flamurbajtësi, i veshur me simbolet e flamurit, Ago Nuhaj, goditet edhe ai. Gjendja shëndetësore është e agruar me shikimin dhe frymëmarrjen. Ky është regjimi i 'hajdutit' psiqik. Fundi është afër!", shprehet ish-deputeti i PD-së.



Protesta e djeshme para parlamentit

### Berisha: Protesta drodhi themelet e kaktivitë

Ish-kryeministri Sali Berisha komentoi dje protestën e opozitës. Në një deklaratë të shkurtër për mediat, Berisha u shpreh se kjo protestë drodhi themelet e asaj, që ai e cilësoi "kaktivitë". "Qindra mijëra qytetarë që vërshuan nga Tirana dhe mbarë Shqipëria, në një protestë, e cila drodhi nga themelet kaktivitë dhe nga ana tjetër ushtoi fuqishëm në mbare botën kundër narkoshtetit të Edvin Kristaq Ramës dhe klikës së tij", tha Berisha. Gjatë protestës së djeshme, ndryshe nga ato të herëve të shkuara, ish-kryeministri nuk u pa gjatë marshimit në krah të kreut të PD-së, Lulzim Basha. Por, ish-lderi i PD-së është shfaqur para godinës së parlamentit dhe kur policia filloi të hidhte gazin lotsjellës me shumicë, madje duke e çuar deri tek lokalet e "5 Majit". Berisha u pa të largohet me shoqëruarit e tij besnikë.

### Ministri Lleshaj: Keqardhje për degradimin e opozitës parlamentare

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, përgëzoi Policinë e Shtetit për mirëmenaxhimin e protestës së opozitës para Kuvendit. Lleshaj shprehet se Policia e Shtetit edhe sot u vu në shënjestër të dhunës së verbër, që mësynte ndaj Kuvendit të Shqipërisë. Ai shpreh keqardhje për degradimin e opozitës parlamentare në gjendje parapolitike dhe respekt për përgjegjshmërinë e profesionalizimin e Policisë së Shtetit. "Edhe sot (dje) Policia e Shtetit u vu në shënjestër të dhunës së verbër që mësynte ndaj Kuvendit të Shqipërisë. Keqardhje për degradimin e opozitës parlamentare në gjendje parapolitike dhe respekt për përgjegjshmërinë e profesionalizimin e Policisë së Shtetit", shkruan Lleshaj në "Twitter".



mje të tjera të forta. Për pasojë u lënduan dhe po mbahen në mbikëqyrje mjekësore 3 punonjës policie, të cilët janë jashtë rre-

ikut për jetën. Edhe mes tubuesve pati të lënduar, si pasojë e efekteve të gazit lotsjellës, të përdorur nga policia për të prapsur tur-

mat e dhunshme. Menjëherë pas mbylljes së tubimit, në vendin ku pati akte dhune mbi forca e rendit dhe ndaj institucionit të rëndësishëm së veçantë u ngrit një grup i posaçëm hetimor", thuhet në deklaratën e Policisë së Shtetit.

### REGJIMI

Partia Demokratike publikoi pamjet e momentit kur është shoqëruar nga policia kryetari i PD-së së Fierit, Luan Baçi dhe djali i tij. Partia Demokratike e quan "hakmarrje të Edi Ramës". Në protestën e organizuar nga opozita e bashkuar, Partia Demokratike pretendon se policia në shenjë hakmarrjeje ka ndaluar kryetarin e PD-së në Fier, Luan Baçi dhe ka dhunuar djalin e tij. "Edi Rama hakmerret ndaj Fierit. I dhunon djalin dhe ndalon kryetarin e PD Fier, ish-deputetin Luan Baçi", shprehet PD. PD informoi se, "janë shoqëruar 20 persona në polici. Për t'u njohur me situatën, në policinë e Tiranës



Policia e papërgatitur për marshimin te parlamenti, shpërndan turmën me gaz lotsjellës

# Protestuesit marshojnë rreth Kryeministrisë, tension para Kuvendit

"Rama ik"! Përplasje me gaz lotsjellës, gur dhe ujë

Valentina Madani

**P**rotestë-marshimi i opozitës dje nisi i qetë, por përgjatë 4 orëve në shesh nuk munguan as përplasjet me policinë. Marshimi i mijëra qytetarëve të mbledhur në Tiranë nga të gjitha qytetet e vendit filloi qetësisht me thirrjet "Rama ik" para godinës së Kryeministrisë. Më pas protesta u zhvendos para parlamentit, ku pati përplasje dhe tension. Protestuesit përdorën gurë drejt policisë, ndërsa policia i shpërndau me gaz lotsjellës dhe me ujë. Të zhvendosur te godina e parlamentit në marshimin e tyre të tretë, protestuesit prishën traun në hyrje këtij institucioni, si dhe hodhën gurë në drejtim të kordonit policor. Kjo mori menjëherë kundërpërgjigjen e policisë, e cila lëshoi gaz lotsjellës, duke shpërndarë turmën. Gjatë gjithë kohës liderët e opozitës, Lulzim Basha e Monika Kryemadhi shoqëruan protestuesit nga Kryeministria te parlamenti, ndërkohë që policia forcoi masat e sigurisë para Kryeministrisë dhe më pas te godina e Kuvendit. Situata para parlamentit ishte e tensionuar. Pati momente kur protestuesit goditën me gurë, ndërsa policia përdori gaz lotsjellës edhe ujë për të shpërndarë protestuesit. Policia bëri thirrje me megafon për të mos kryer vepra penale. Një makinë shpërndau ujë për të mbajtur larg protestuesit.

## THIRRJA

Të mbledhur para godinës së Kryeministrisë, ish-deputeti Flamur Noka u kërkoi qytetarëve që ta ndiqnin dhe të marshonin në këtë protestë marshimi siç e quajti ai, rreth Kryeministrisë. "Kjo është protesta më e madhe që



## PARALAJMËRIMI

"Do ketë përshkallëzim, ne kemi deklaruar stinë protestash dhe do ketë përshkallëzim. Faza e parë ishte kjo. Edi Rama s'do jetë i qetë as në shtëpinë e tij. Nuk do mund të ushtrojë detyrën e kryeministrit në asnjë cep të Shqipërisë, qytetarët e kanë shkarkuar", - tha Flamur Noka në "News 24".

## HIMNI KOMBËTAR

Edhe protesta e djeshme e opozitës është mbyllur me Himnin Kombëtar. Kësaj radhe himni është kënduar nga të gjithë protestuesit e mbledhur në selinë e PD, si dhe nga kryetari Basha dhe përfaqësues të tjerë. Basha deklaroi se protestat do të jenë të përditshme dhe të përnatshme.

## TË LËNDUARIT

Për shkak të gazit të përdorur në masë, disa prej protestuesve kanë mbetur të lënduar. Në ndihmë tyre erdhi autoambulanca. Gjithashtu, edhe efektivët e policisë janë ndier në veshitësi, ndaj edhe është kërkuar marrja e ndihmës së parë. Qëndresa bëri që ndaj protestuesve të hidhej sasi e madhe e gazit lotsjellës, për këtë shkak në spital mori ndihmën e parë edhe nënkryetari i PD, Edi Paloka.

ka njohur ndonjëherë historia. Kjo është shenjë e revoltës më të madhe popullore ndaj një regjimi. Ne sot po bëjmë një muaj, kur ju, qytetarët e Shqipërisë, popullit vendosi të shkruajë historinë e vet. Është dita kur këto zyra, ky kryebandit mori një mesazh dhe mesazhi çdo ditë e më shumë këmbon: Rama Ik! Rama ik, sepse ti

nuk mund të rrih më në atë karrige, por je i rrethuar kudo që të shkoh nga revolta e popullit tënd. Kjo protestë do të jetë marshim, sepse ne do të tregojmë që dimë të protestojmë, që përfaqësojmë vlerat e qytetërimit. Kjo protestë do të jetë marshim. Na ndiqni në këtë marshim proteste dhe revolte ndaj kryebanditit. Populli ka folur.

Është koha e veprimt qytetar. Marshim proteste ndaj bandës përpara", tha Noka. Pas kësaj, bashkë me qytetarët, kreu i PD-së dhe përfaqësuesit e opozitës nisën marshimin. Ata kaluan pas godinës së Kryeministrisë duke përshkruar të gjithë zonën përreth për t'u rikthyer sërish në bulevard. Gjatë kohës që kalonin pas godinës së kryeministrit, protestuesit rrëzuan rrethimin e vendosur nga policia. Megjithatë, deri në këto momente protesta e opozitës është e qetë.

## NDËRRHYRJA

Garda dhe forcat e rendit u gjendën të papërgatitur për marshimin e opozitës para selisë së parlamentit. Me mbërritjen e grupit të parë u shfaq një numër i vogël i forcave të rendit të vendosura para godinës. Në përplasjen e parë, disa prej pjesëmarrësve kanë arritur të thyenin gardhin, por përgjigjia ka qenë me gaz lotsjellës. Forcat e Ndërrhyrjes së Shpejtë dhe automjetet që hedhin ujin me presion janë nisur menjëherë drejt Kuvendit. Por kanë hasur me rezistencën e protestuesve të vendosur te pedonalja, të cilët u ulën në shesh për të mos lejuar kalimin. Gazi lotsjellës ka sjellë shpërndarjen e turmës, ndërsa është përdorur edhe uji me presion për të zhbllokuar rrugën. Për shkak të gazit të përdorur në masë, disa prej protestuesve kanë mbetur të lënduar. Në ndihmë tyre erdhi autoambulanca. Gjithashtu, edhe efektivët e policisë janë ndier në veshitësi, ndaj edhe është kërkuar marrja e ndihmës së parë. Qëndresa ka bërë që ndaj protestuesve të hidhej sasi e madhe e gazit lotsjellës, për këtë shkak në spital ka marrë ndihmën e parë edhe nënkryetari i PD, Edi Paloka.

## GAZI LOTSJELLËS

Gazi i hedhur nga policia gjatë protestës nuk kurseu as liderët e opozitës, Bashën e Kryemadhin, por edhe ish-deputetë të tjerë. Gjatë zhvendosjes së turmës para parlamentit, protestuesit kanë kordonin, ndërsa policia reagoi duke hedhur gaz lotsjellës. Të prekur nga gazi ishin edhe liderët e opozitës. Basha dhe Kryemadhi, e cila është kapur nga kamerat duke mbajtur një shami përpara fytyrës.

## "Mijëra në shesh kundër qeverisë", mediat e huaja jehonë protestës së opozitës

**P**rotesta e opozitës mori sërish dje vëmendjen e mediave ndërkombëtare, si "Associated Press", "The Washington Post", "New York Times", "Fox News", "Zëri i Amerikës", ndërsa agjencia ndërkombëtare e lajmeve "Reuters" ka transmetuar pamjet drejtpërdrejtë gjatë kohës së mbajtjes së tubimit. Me titullin "Mijëra në shesh kundër qeverisë", "Associated Press" shkruan se mbështetësit e Partisë Demokratike u mblodhën përpara Kryeministrisë për të kërkuar rrëzimin e qeverisë dhe zgjedhje të parakohshme. Protestuesit dhe liderët e opozitës akuzojnë qeverinë për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar, thekson agjencia ndërkombëtare e lajmeve. Duke iu referuar AP, edhe "The Washington Post" raporton se opozita refuzon të dialogojë me Ramën, duke kërkuar një qeveri tranzitore për të përgatitur zgjedhje të parakohshme. "Zëri i Amerikës" ka përshkruar edhe tensionet e krijuara përpara godinës së parlamentit. "Në Shqipëri, policia përdori gazin lotsjellës pasi një grup manifestuesish të opozitës tentuan të çanin kordonin e sigurisë në hyrje të selisë së parlamentit, ku opozita u grumbulloi pas marshimit të saj rreth godinës së qeverisë". Protesta është pasqyruar edhe në mediat italiane. Agjencia italiane e lajmeve, "Ansa" thekson se autoritetit shqiptarë angazhuan 1800 agjentë, vendosen kamera të sigurisë dhe fortifikuan dyert dhe dritaret e Kryeministrisë për shkaqe sigurie. Ndërkaq, të gjitha mediat ndërkombëtare raportojnë paralajmërimet e delegacionit të BE-së dhe ambasadës së SHBA-ve ndaj opozitës për të shmangur përdorimin e dhunës.

# PROTESTA AKUZAT

**AMBASADORI BRITANIK: VETËPËRMBAJTJE**  
Ambasadori britanik në Tiranë, Duncan Norman, bëri dje thirrje për vetëpërmbajtje. Në një postim në "Twitter" ambasadori shkruan: "Sot (dje) është një mundësi për të ushtruar të drejtën tuaj të protestës. Megjithatë, kjo e drejtë duhet ushtruar në mënyrë paqësore. Dhuna minon demokracinë. Iu bëjmë thirrje të gjithëve të tregojnë përmbajtje. Të respektojnë institucionet demokratike dhe parimet një proteste paqësore".



Kreu i PD: Protestë çdo ditë e çdo natë, deri sa ta çlirojmë vendin nga kriminelët

## Protesta, Basha-ndërkombëtarëve: Nuk ka stabilitet pa demokraci

*"Nuk përçahemi, as kokën nuk e ulim para krimit"*



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje me protestuesit para Kryeministritë

**Valentina Madani**  
Lideri i opozitës, Lulzim Basha, pas 4 orësh protestë, lajmëroi mbështetësit e shumtë të PD-së se do të protestohet çdo ditë derisa vendi të çlirohet nga kriminelët dhe Shqipërisë t'i hapet rruga drejt BE-së. Pas tërheqjes nga parlamenti ku pati incidente, Basha i drejtoi mbështetësit e vet te selia e PD-së, ku mbajti edhe një fjalim përmblyës. Ai tha se Rama do të mbajë përgjegjësi për dhunën që policia ushtroi në proteste ndaj qytetarëve. Para mbështetësve, Lulzim Basha tha se dita e sotme (djeshme) hyri në histori "si dita e dytë e zgjimit kombëtar, si dita e bashkimit më të madh që Tirana ka njohur në historinë e saj. Për këtë, çdo shqiptar sot dhe çdo brez sot ju ka një borxh mirënjohje ju, misionarëve të lirisë, të demokracisë". "Sot (dje) më në panik se kurrë kufoma politike e Edi Ramës dhe klikës së tij kriminale, përshkallëzoi dhunën e paporokuar ndaj protestuesve për t'i trembur, për t'i provokuar, për t'i larguar nga rruga e protestës. Por përgjigjen e mori nga populli. E gjitha Shqipëria dhe bota e ka parë sot vendosmërinë e një populli të bashkuar. Dita kur do të shkojë para drejtësisë po afron. Nuk ka rrugë tjetër për të kthyer demokracinë, përcëq protestave popullore. Ishim shumë më 16 shkurt jemi shumë më shumë sot më 16 mars. 16 shkurti i hapi rrugën një vërshimi popullor; që nuk do të ndalet më kurrë", deklaroi kreu i PD-së. Basha kishte një mesazh edhe për partnerët ndërkombëtarë, të cilëve iu drejtua në anglisht për t'i thënë se nuk mund të ketë stabilitet pa demokraci. "Dua t'u drejtoj një mesazh të qartë miqve tanë përëndimorë që na kanë mbështetur në këto 29 vite, 'No stability without democracy' (s'ka stabilitet pa demokraci). Ftesa ime është mos e dëgjoni autoritatin Rama, që e zhyti vendin në drogë, dëgjoni zërin e qytetarëve". Teksa lajmëroi fundin e protestës këtë të shtunë, kreu i opozitës tha se revolta popullore nuk do të ndalet,



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në protestë

**MESAZHI**  
"Dua t'u drejtoj në emrin tuaj një mesazh të qartë miqve tanë përëndimorë, që na kanë mbështetur në 29 vite demokraci 'no stability without democracy, no stability without rule of law'. Mos e dëgjoni autoritatin Edi Rama, dëgjoni zërin e qytetarëve", deklaroi z.Basha.

### Kryemadhi: Qytetarët do të largojnë Ramën, loja ka filluar të luhet fort

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, e ftuar dje në emisionin "Kjo Javë" në "News 24" pas përfundimit të protestës theksoi mirënjohjen ndaj qytetarëve, ndërsa protestën e vlerësoi me një numër dyfish pjesëmarrësish. Më herët ajo deklaroi se loja ka filluar të luhet fort dhe opozita është e vendosur për të qeverisim zemërimin dhe indignitetin e qytetarëve shqiptarë, për të përmbushur një akt patriotik që është integrimi në Bashkimin Europian. "Sot qytetarët u përballën pa bërë asnjë hap



pas, përballë pushtetit të grabituar, kriminal dhe të pamoralshëm të Edi Ramës. Populli tashmë e ka marrë vendimin e tij. Rruga tashmë është nisur për të shpëtuar demokracinë dhe lirinë e njerëzve. Ky është vendimi që qytetarët kanë marrë, opozi-

ta do ta udhëheqë atë në çdo orë dhe çdo ditë. Tashmë rruga jonë nuk ka më kthim pas, do të qeverisim zemërimin dhe indignitetin e qytetarëve shqiptarë për të përmbushur një akt patriotik, që është integrimi në Bashkimin Europian. Qytetarët do të largojnë pengesën e vetme që kanë për ëndërrin europiane, që mban emrin Edi Rama. Rruga e vetme që ka Shqipëria është integrimi në BE. Sot ai mori një shuplakë, loja tashmë do të hyjë prej vërteti, ka filluar të luhet fort", tha z.Kryemadhi.

**VENDIMI**  
"Ne do e vazhdojmë këtë betejë në çdo qytet, në çdo lagje, dhe shtëpi të shqiptarëve. Do e çlirojmë Shqipërinë nga krimi dhe kriminelët derisa ta bëjmë si e gjithë Europa. Kërkesa jonë është largimi i kryehajduit, i cili ka pesë javë që nuk duket sa herë që ne bëjmë protestë. Ditë për ditë dhe natë për natë do jemi në protestë, në përballje kundër të keqes në pushtet deri në zgjedhje të lira", tha z.Basha.



Rudina s'dorëzoi mandatin, i vëllai në krah të Bashës

### Salianji kërkon reflektim nga Hajdari: Falja është hyjnore

Rudina Hajdari ka refuzuar të dorëzojë mandatin e deputetes, por i vëllai i saj, Kiri Hajdari është parë në protestë në krah të kreut të PD, Lulzim Basha. Djali i Heroit të Demokracisë ka marrë pjesë në të gjitha protestat e organizuara nga opozita. Rudina Hajdari pak ditë më parë deklaroi se nuk do të dorëzojë mandatin e deputetes. Ish-deputeti Ervin Salianji deklaroi dje se ka vend për të reflektuar edhe nga deputetja Rudina Hajdari, e cila nuk dorëzoi mandatin. "Mendoj që në një moment të caktuar të gjithë ata që janë votuar nga PD do të reflektojnë dhe do të rikthehen përsëri për të kontribuar, apo për të kthyer kontributin që i kanë dhënë votuesit e PD-së", deklaroi z.Salianji. I pyetur nëse dyert e PD-së mbeten të hapura për rikthimin e të përjashtuarve, Salianji thotë se kjo parti e ka thënë fjalën e saj për shkeljen e vendimmarrjes së forumeve, por falja është hyjnore. "PD i ka marrë vendimet e saj. Kjo është një vendimmarrje kundër vendimeve të forumeve të partisë dhe është personale, nuk është e interesit publik. Cilido ka mundësinë të reflektojë, falja është hyjnore", tha ish-deputeti i PD-së.

madje do të vazhdojë ditë për ditë në çdo lagje dhe qytet deri në largimin e Ramës. "Në nuk do e ulim kokën dhe nuk do të përçahemi përpara një qeverie të kapur nga krimi. Nuk do e pranojmë kurrë këtë parlament që po kthehet në pazar. Ne do e vazhdojmë këtë

betejë në çdo qytet, në çdo lagje dhe shtëpi të shqiptarëve. Do e çlirojmë Shqipërinë nga krimi dhe kriminelët derisa ta bëjmë Shqipërinë si e gjithë Europa. Kërkesa jonë është largimi i kryehajduit, i cili ka pesë javë që nuk duket sa herë që

ne bëjmë proteste. Ditë për ditë dhe natë për natë do jemi në proteste, në përballje kundër së keqes në pushtet deri në zgjedhje të lira dhe të ndershme. Fitore demokracisë, fitore popullit! Shqiptarët e bashkuar kanë për të fituar!", tha z.Basha.



Kryeministri: Protestat rrëmujë politike, dëmtojnë ekonominë dhe turizmin

# Rama: S'ka shans të rrëzohet qeveria e votuar nga shqiptarët

*"Doktoresha' do të dorëzojë Beratin e Gjirokastrën"*

**K**ryeministri Edi Rama nga Berati e bëri të qartë opozitarëve, të cilët protestonin në të njëjtën

kohë para godinës së Kryeministrit se qeveria nuk preket, për aq kohë sa ka marrë besimin e shumicës së popullit. Ata që protestojnë, sipas kryeministrit, janë rrogatë të politizuar, të cilët thirren për të bërë rrëmujë politike. Kryeministri i nxitur nga fjalët e një prej operatorëve turistikë në Berat komenton protestën e opozitës, që sipas tij nuk ka asnjë shans të rrëzojë një qeveri të ardhur me votën e shqiptarëve, por po dëmton turizmin dhe ekonominë e vendit. "Nuk desha ta prekja sot këtë aspekt, por duke qenë se ju e prekët, fatkeqësisht ajo që ndodh me poli-

tikën, gjithmonë ndikon kur ndodh për keq, sjell keq, jo mirë dhe në këtë rast që ka ndodhur, e vetmja pikë dhe i vetmi segment që nuk cenohet, sado paradoksale të jetë, është qeveria dhe shumica qeverisëse në aspektin e numrave, gjithçka tjetër preket. Qeveria nuk preket, shumica qeverisëse nuk preket, se nuk është një mur që i bie dhe e shemb. Është një mandat besimi i shumicës së popullit dhe ndryshon vetëm kur i vjen radha popullit që të gjykojë nëse duhet ta rinovojë atë mandat besimi apo t'ia kalojë dikujt tjetër, ndërkohë që preket ekonomia e kujt do", tha z.Rama. Si-

pas kryeministrit, opozita po u jep mundësi vendeve skeptike që të justifikojnë votën kundër hapjes së negociatave për Shqipërinë. Gjithsesi, Rama shprehet i sigurt që ky aksion i opozitës shumë shpejt do të fashitet. "Dhe ata që shkojnë në protesta të organizuara dhe të orkestruara për t'u materializuar në dhunë, një pjesë janë rrogëtarë, të cilët marrin një rrogë si punonjës të administratave lokale politike dhe të tejpolitizuara dhe që bëjnë detyrën e tyre ndaj partisë, që marrin autobusin e vijnë në protestë. Dhe të thuash punëtorë të ndërmarrjes-parti që i thërret në një rrëmujë politike dhe mbase për ta llogarja, sado dritëshkurtër është më e thjeshtë, marrim rrogën dhe bëjmë këtë punë. Por për këdo tjetër që jeton me punë është të shkojë për t'u rënë këmbëve të veta, për të penguar veten të shkojë më tutje", u shpreh Rama.

**AMBICIA**

Kryeministri Edi Rama kërkon që në zgjedhjet e 30 qershorit të marrë dy bashkitë, që aktualisht i drejton LSI-ja, atë Beratit dhe të Gjirokastrës. Nga qyteti i Beratit, ai tha se qeveria në mandatin e ardhshëm do të investojë për të rritur në 300 mijë numrin e vizitorëve. "Një program i veçantë bashkëpunimi i qeverisë dhe Bashkive Gjirokastër dhe Berat pasi, t'i ketë dorëzuar 'doktoresha' dhe t'i kemi marrë dhe me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, do të bëjë që në mandatin e ardhshëm të bëjmë një transformim të madh. Kemi vajtur nga 13 mijë në 110 mijë vizitorë, në 4 vjet në 4 vitet e ardhshëm duhet të shkojmë 300 mijë vizitorë", u shpreh z.Rama. Duke folur për turizmin, kryeministri njoftoi se edhe në Korçë do të ndërtojmë muzeun e rakisë.



Kryeministri Edi Rama

**BRAÇE NXJERR VIDEON: KAQ JE LULZIM**

Zv.kryeministri Erion Braçe reagoi dje pas protestës së organizuar nga opozita. Braçe, përmes një postimi në "Instagram" shkruan se kreun e PD-së, Lulzim Basha, nuk ka popull që e ndjek. Ndërkaq, zv.kryeministri nuk kursen edhe kritikën për ish-qeverinë e PD-së, teksa i kujton edhe Gërdecin. Braçe ndër të tjera shkruan se PD ka vjedhur dhe vrarë popullin si kurrkush më parë. "Kaq je Lulzim, veç kaq! Nuk ke popull dhe ky është problemi yt! E di pse? Sepse ti dhe ju e keni vjedhur e vrarë popullin! E keni bërë si kurrkush para e pas jush! A ju kujtohet 15 marsi? A ju kujtohet Gërdeci? Ka Zot lart! Ka popull të tij në tokë!", shprehet z.Braçe.

**Tirana International Airport**  
 Nënë Tereza

**TENDER NOTIFICATION**

**TENDER OPPORTUNITY FOR TAXI SERVICE BUSINESS at TIRANAINTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

**Prospective tenants are expected to meet the following requirements:**

- Experience of provision and installation of taxi services (not necessarily service for airport). Please note at least 1 year of experience is necessary.
- Taxi license of the company related to the subject of the concession (any company which fails to meet the above criteria will not be taken into consideration).
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas, only on 19 March 2019 up to 15:00 Eastern Time.

Only to the companies that will submit a formal request for participation will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or **to all** the following email address:

**Tirana International Airport Nënë Tereza SH.P.K**  
 Administration Building  
 Commercial & Property Department  
 Rinas, Albania

Emails:  
 Commercial Department      Alisa Gjinari    [agjinari@tirana-airport.com](mailto:agjinari@tirana-airport.com)  
 Legal Department                Ilir Alimema    [ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com)  
 Procurement Department      Albi Palushi    [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com)

Tirana International Airport SHPK  
 Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania  
 Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545  
 E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

Publikohet formulari që duhet të plotësojnë përfituesit dhe oraret e takimeve

# ATP, grafik për takime dhe ankesa për dosjet e pronarëve

*Dosjet e patrajuara, procedura për tërheqjen e dokumenteve*

**P**ronarët që kanë marrë një vendim për një hjen dhe kompensimin e pronës dhe duan një informacion në lidhje me procedurën që do të ndiqet për kompensim mund të marrin informacion pranë Agjencisë së Trajtitimit të Pronave, pasi të kenë plotësuar një formular-tip. Agjencia bën të ditur se për të gjithë të interesuarit që kërkojnë takim apo kanë një ankesë, mund ta bëjnë një takim, ose duke plotësuar formularin. "Orari i ofrimit të shërbimeve është nga e hëna në të enjte, ora 08.00 deri në 14.00 dhe të premten, ora 8.00 deri në 13.00", - thuhet në faqen zyrtare të ATP-së, ku publikohet edhe formulari.

**APLIKIMI**

ATP bën të ditur se shërbimi jepet edhe në portalin "e-Albania" për aplikimin për ankesë dhe trajtimin të dosjes me specialistin përkatës, si dhe aplikimin për kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes. Me anë të dërgimit 'online' të kërkesës për marrjen e informacionit, vetë Agjencia e Pronave, përmes personave përgjegjës kryen shqyrtimin e kërkesës bashkë me dokumentacionin shoqërues. Në rastin kur kërkesa është e rregullt, ajo trajtohet nga specialistët dhe brenda 30 ditësh qytetarit të interesuar i kthehet përgjigja 'online' përmes 'email'-it, si dhe te seksioni "Hapësira ime" në portalin "e-Albania". Në rast se përgjigja kërkohet edhe në letër, atëherë qytetari duhet të paraqitet fizikisht pranë sporteve të ATP-së. Edhe kur aplikimi për kërkesën nuk është sipas rregullave të paracaktuara, sërish njoftimi i qytetarit bëhet me 'email', duke shmangur cdo lloj keqkuptimi të mundshëm. "Gazeta Shqiptare" zbardh të gjithë procedurën që duhet të ndiqet për aplikim si dhe dokumentet që duhet të dorëzohen përmes portallit qeveritar. Kostoja e aplikimit është 3 mijë lekë, ndërsa afati i shqyrtimit të kërkesës është 30 ditë.

**DOSJET E PATRAJTUARA**

Agjencia e Trajtitimit të Pronave bën të ditur edhe procedurën që duhet të ndjekin rreth 7 mijë pronarë për kërkesat e të cilëve nuk është marrë asnjë vendim nga ky institucion. Ish-pronarët duhet të tërheqin dosjen pranë ATP-së për të ndjekur më pas rrugën gjyqësore për të marrë kompensimin mbi pronën e konfiskuar në vitin 1945. Agjencia e Trajtitimit të Pronave mbylli në 23 shkurt të këtij viti procesin e vlerësimit financiar të dosjeve të ish-pronarëve, por mbetën pa përfunduar procesin 6.950 dosje. Me anë të një njoftimi, ATP-ja u kërkon pronar-




Agjencia e Trajtitimit të Pronave

ëve të drejtohen gjykatës për të marrë vlerësimin dhe kompensimin e pronave, pasi prej tre vjetësh nuk ka mundur të përfundojë shqyrtimin e tyre.

ATP-ja kishte marrë për-sipër të kryente vlerësimin për 16.462 pronave brenda tri viteve, por ky afat skadoi në 23 shkurt. Pronarët që presin të marrin kompensimin

për pronën kanë aplikuar që në vitin 2015, por deri tani jo vetëm që nuk kanë marrë kompensimin, por as nuk janë njohur ende me vlerësimin financiar.



**Koncesioni i TEC-it të Vlorës**

Ministria e Energjisë pezullon përkohësisht garën

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bëri të ditur të shtunën se ka pezulluar përkohësisht procedurën e dhënies me koncesion të termocentralit të Vlorës. Me një njoftim për mediat, ministria shprehet se pezullimi është bërë me qëllim dhënien e përgjigjes për informacionet shtesë të kërkuara nga kompanitë e interesuara. Sipas ministrisë, ky vendim synon mundësimin e pjesëmarrjes të sa më shumë ofertuesve në garë. Si pjesë e procedurës konkurruese, më datë 15 janar u zhvillua një vizitë në terren, në të cilën morën pjesë 27 përfaqësues nga shoqëritë të interesuara. 23 prej tyre kanë marrë akses në bazën ku nodhen të dhënat teknike dhe financiare rreth termocentralit ekzistues të Vlorës. Pas vizitës në terren, nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar u paraqitën 48 kërkesa për sqarime shtesë, të karakterit teknik dhe ligjor. Me qëllim sqarimit e këtyre kërkesave, procedura e dhënies me koncesionit është pezulluar përkohësisht. Për momentin, ministria nuk ka dhënë afate kohore për rihapjen e garës. TEC-i Vlorës nuk është vënë asnjëherë në punë që nga ndërtimi i tij. Gara e hapur nga qeveria parashikon investime për kthimin e tij në gjendje pune dhe modifikimin e teknologjisë, në mënyrë që ai të funksionojë me gaz natyror dhe jo më me gazoil.

**Penalite për parkimet**

Rreth 83 mijë gjoba në një vit për shkelje të rregullave

Mbi 94 mijë gjoba janë vendosur në një vit vetëm në 11 njësitë e vjetra të kryeqytetit. Duke i bashkëngjitur ndëshkimet për zonat rurale, numri i masave administrative arin në mbi 103 mijë. Referuar të dhënave zyrtare të Policisë Bashkiake për vitin 2018, ndëshkimet për shkelje të rregullave të parkimit rrugor, e kryesisht parkimet e gabuara, mbajnë rekordin e shkeljeve në mbi 74 mijë, ku duke shtuar edhe ato në zonat rurale arrijnë në rreth 83 mijë. Duke llogaritur një mesatare 1 mijë lekë për gjobë, niveli i të ardhurave vetëm nga parkimet e gabuara arin në 83 milionë lekë. Vendin e dytë për nga numri i shkeljeve e në njësitë urbane e zënë aktivitetet pa leje, me 14,215 gjoba dhe më pas renditet zënia e hapësirave publike me 2645 ndëshkime dhe mungesë dokumentacioni, 2543 gjoba. Ndërsa më pak masa janë ndërmarrë për ndotje mjedisi në rreth 307, 100 gjoba të ndryshme, 50 masa administrative për prishje të qetësisë publike dhe në fund renditet shpërdorimi i ujit të pijshëm me 41 gjoba.



**GJOBAT NË NJËSITË URBANE**

- Parkime të gabuara, 74.191
- Aktivitet pa leje, 14.215 gjoba
- Zënie të hapësirave publike, 2645
- Mungesë dokumentacioni, 2543 gjoba
- Gjodat në njësitë urbane
- Ndotje mjedisi, 307 gjoba
- Të ndryshme, 100 gjoba
- Prishje e qetësisë publike, 50 gjoba
- Shpërdorim i ujit të pijshëm, 41 gjoba

**Shkodër/ Familjarët reagojnë: Masë e ashpër sigurimi**

**Akuzohen për dhënin e parave me fajde, gjykata lë në burg 12 të arrestuarit**

Gjykata e Shkodrës ka rikonfirmuar masat e sigurisë, duke dhënë "arrest me burg" për 12 personat e arrestuar si pjesë e një grupi që jepnin fajde me interes, që shkonte deri në 20% në javë. Vendimi nuk u prit mirë nga familjarët e të arrestuarve, të cilët thanë se masa është e ashpër. Ata u arrestuan në kuadër të operacionit "Maranaj", me masën e sigurisë "arrest me burg" të dhënë më herët nga gjykata. Të gjithë të akuzuarit kërkuan lirinë. Skema u denoncua nga ish-prefekti i Shkodrës, Paulin Radovani. Të përfshirë sipas prokurorisë rezultojnë ish-kancelari i Gjykatës së Sh-

**MASA E SIGURISE**  
Vendimi nuk u prit mirë nga familjarët e të arrestuarve, të cilët thanë se masa është e ashpër. Ata u arrestuan në kuadër të operacionit "Maranaj", me masën e sigurisë "arrest me burg" të dhënë më herët nga gjykata. Të gjithë të akuzuarit kërkuan lirinë. Skema u denoncua nga ish-prefekti i Shkodrës, Paulin Radovani.



Foto ilustruese

kodrës Artan Dragani, një notere dhe një efektiv policie. Gjatë operacionit u sekuestruan shumë të mëdha parash, prona të luajtshme dhe të paluajtshme. Skema

ishte e tillë që nëse qytetarët ose biznesmenët nuk kthenin shumat në kohë, ata humbnin prona që kishin lënë peng me marrëveshje. Të arrestuar për skemën e fa-

jdeve në Shkodër janë Byrhan Alija, 61 vjeç nga Shkodra; Edi Memçaj, 33 vjeç nga Shkodra; Adri Bala 22 vjeç, nga Shkodra; Artan Dragani 39 vjeç nga Shkodra, Marjan

Bregu 31 vjeç nga Shkodra, Vinko Nikprelaj 37 vjeç lindur në Podgoricë dhe banues në Shkodër; Eduard Fusha, 38 vjeç nga Shkodra; Elidon Qerimaj, 41 vjeç, nga Shko-

dra, Pashko Vuksanlekaj, 54 vjeç nga Shkodra; Lul Sylja, 48 vjeç nga Shkodra; Ilir Sokoli Naim Ahmetaj, 52 vjeç lindur në Pukë dhe banues në Tiranë.

Ekzekutohet me armë Haxhi Baxhinovski, ish-i përndjekur politik në diktaturë

# Tmerri, vritet 62-vjeçari në sy të djalit të Liqeni

*Dyshimi, konflikt i hershëm. Policia: I njohim autorët*

Një atentat ndodhi mbrëmë në Tiranë në zonën e Liqenit Artificial, ku dy persona me maska vranë me armë zjarri 62-vjeçarin Haxhi Baxhinovski në sy të djalit të tij të mitur. Ky i fundit ishte duke vrapuar te kodrat e liqenit bashkë me djalin e tij të mitur kur dy personat i janë afruar dhe e kanë qëlluar për vdekje, ndërsa i biri, por edhe kalimtarë të rastit u shpëtuan fatmirësisht plumbave. Gazetarja Dorjana Bezat tha për "Balkanweb" se personat që qëlluan mbi burrin nga Mallakastra, referuar dëshmi të mbledhura në vendngjarje ishin të maskuar dhe të veshur me xhupa të zinj. Ata janë larguar me shpejtësi menjëherë pas krimit. Referuar burimeve policore, bëhet fjalë për dy persona nga Fieri me inicialet I.S. dhe I.B.. Po ashtu, ngjarja dyshohet se ka ndodhur si pasojë e një konflikti të hershëm, i cili pritet të sqarohet nga momenti në moment.

**NJOFTIMI I POLICISË**

Tiranë  
Informacion paraprak Rreth orës 18:15, tek Liqeni Artificial është vrarë me armë zjarri shtetasi H.B., 62 vjeç. Policia ka identifikuar autorin dhe po punon për kapjen e tij.  
"Balkanweb" mëson se bëhet fjalë për një ish-të përndjekur, i cili në kohën e regjimit komunist është dënua dy herë. Haxhi Baxhinovski lindi më 2 korrik të vitit 1957, në fshatin Radostinë të Fierit. Më 30 janar 1982, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet



62-vjeçari Haxhi Baxhinovski



Vendi ku ndodhi vrasja

**IDENTIFIKIMI**  
Dyshohet se ka qenë djali i viktimës, ai që mund të ketë dalluar personat e sipërpërmendur. Mbi viktimën ka qëlluar njëri prej tyre, ndërsa tjetri e ka ndihmuar të arratisen.

Shefqet Baxhinovski ka qenë i dënua në kampin e Qafës së Barit, madje ka marrë pjesë edhe në revoltën e Qafës-Barit. Dyshohet se fteraku është qëlluar për vdekje për shkak të një konflikti të hershëm, ende i pasqaruar nga poli-

cia. Deri më tani janë identifikuar dy autorët e ngjarjes, të dy nga Fieri dhe janë shpallur në kërkim. Dyshohet se ka qenë djali i viktimës, ai që mund të ketë dalluar personat e sipërpërmendur. Mbi viktimën ka qëlluar njëri prej

tyre, ndërsa tjetri e ka ndihmuar të arratisen. Ngjarja e rëndë ndodhi djeg rreth orës 18:15, te Liqeni Artificial, ndërsa Baxhinovski kishte dalë për vrap bashkë me djalin e tij. Policia ka identifikuar autorët dhe po punon për kapjen e tyre.

kohë për "agjitacion e propagandë".

Ai u dënua sërish më 3 qershor 1984, kësaj radhe me 21 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për "veprën e terrorit në bashkë-punim" (dënim i kombinuar). Haxhi

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbanues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 08.04.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i liri-të për shijën e pasurisë së paluajtshme. Apartment me sipërfaqe totale 45.3 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 56/28+1-26, Vol.13, Fq.41, Zk-39/76 në pronësi të Hipotekës së shtet, Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 9,132.48 (Nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e dy pikë dyzet e tetë) EURO dhe Apartment me sipërfaqe totale 63.3 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 56/28+1-26, Vol.13, Fq.42, Zk-39/76 në pronësi të Hipotekës së shtet, Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 12,761.28 (Dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet e tetë) Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbanues Gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoa", Pallati 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 02.04.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i liri-të për shijën e pasurisë së paluajtshme. Apartment me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 5/194/1+1-0, Volumi 7, Fq. 177, Zona K.adastrale 220 në pronësi të debitorit Z.Arjan Xhevut Gjonaj me vlerë fillestare në ankand 100.000 (njëqind mijë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com.

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën 6 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilin dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

#### KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

# Dosjet 1993-2013, lista me 6 611 pronarët që marrin paratë

## Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

#### LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

### LISTA ME 6 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Tiranë	SHYQYRIE HANIFE CULLAJ		7588
Tiranë	Abaz Skuqi		3000
Tiranë	NAFJE DAKA		0
Tiranë	MYSLYM DEMNERI	45	162
Tiranë	SKENDER ARAPI		0
Korçë	Elvin Spaho	230	1000
Korçë		390	160
Tiranë	BESNIK PRUSHI	3075	1870
Tiranë	MYZEJEN DEDAJ	161	239
Dibër	Nexhmie Sopot	1080	0
Durrës	Remzi Tivari		1705.45
Fier	Feti Ramushi	6900	3460
Fier	Ferit Turku	800	200
Fier	Hekuran Thana	9400	560
Korçë	Ana Myrto	2315	685
Korçë	Ysen Dervishi	198	987
Korçë	Avni Vivo	710	640
Korçë	Resime Bako		1724
Korçë	Hajdar Mersini		895
Korçë	Hekuran Mehmet		600
Korçë	Shyqyri Abazi		1944
Tiranë	HALIL HASA	7880	0
Tiranë	NAZE MUCA	1810	2414
Vlorë	Llambë Jakubini	852	598
Korçë	Bejaze Jaupi	1233	630
Korçë	Hasan Hasani		2256
Fier	Muhamet Krakulli	1525	65675
Fier	Haxhi bejta	825	1095.5
Korçë	Sefedin Selimi	804	511
Shkodër	Nikoll Nikoll	1250	11208
Korçë	Mevlude Lico	3725	1060
Tiranë	MYFTAR, HYSEN SARACI		0
Tiranë	ALI GUMA		191
Tiranë	LILJANA CIVICI	110	210
Berat	Qani Naço		5110
Berat	Muharem Toto	800	6500
Dibër	SULEJMAN DHE LSAJ ILIJAZ ZEMELLI		3570
Gjirokastrë	Keshilli I kishes se shenje		2500
Korçë	Saliqe Rushitaj		768
Korçë	Vaskë Lubonja		14.1

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Korçë	Eli Tira	690	3310
Kukës	Alush Gafurr Luma		3420
Kukës	Vehbi Mustaf Ibrahim	3774	1926
Kukës	Liman Dali Halili	4836	790
Kukës	Hasan Zyber Sina	3814	900
Kukës	Tahir Islam Nuhiallari		2686
Vlorë	Artur Beshiri	400	1670
Vlorë	Myfit Muço		2200
Dibër	Dail Osmani		315
Durrës	Ali Kerluku		128
Durrës	Meleq Kalamishi		6092
Durrës	Jorgji Spiru		549
Gjirokastrë	Fatbardha Jaho	5000	10650
Lezhë	Gjete Dod Kola	5844	2892
Gjirokastrë	Dhimiter Dhespo	220	1519.4
Berat	Refat Terpo		1350
Berat	Iljaz Metani		934
Berat			1000
Berat	Gani Bajraktari	2500	14000
Berat	Shqiponja Ismailari		2057
Fier	Dervish Quka	970	2300
Fier	Afrim Zemblaku	2000	1440
Fier	Tahir Korreshi	1750	2990
Fier	Tahir Korreshi	4000	12700
Fier	Zenepë Manati	5000	1950
Fier	Rexhep Hysi	2600	300
Fier	Novruz Quka	4663	2177
Fier	Sadedin Hoxha		1850
Fier	Vath Sefa	1320	3280
Fier	Bajram Sefa		670
Fier	Izet Shima		850
Fier	Rahman Xhaja	690	10460
Fier	Pranvera Borici		700
Fier	Tefik Malaj	383	6727
Fier	Meki malaj		3600
Fier	Perparim Pashaj	4440	12405
Fier	Nasibi Sulaj	1800	300
Fier	Tomorr Shehu	5000	1500
Gjirokastrë	Sabri Shabani		1070
Gjirokastrë	Violeta Merkuri		320



Gjirokastër	Islam Bundo		2747
Gjirokastër	Ahmet Tartari		1420
Gjirokastër	Merushë Delilaj		546
Gjirokastër	Brahim Elezi		2414
Korçë	Domka Qam Kendezi, Nevruz Qam Kendezi	334	5150
Korçë	Isuf Shehu		2980
Korçë	Eqerem Isaj		2721
Korçë	Alie Koçiu	1879	1476
Korçë	Bajram Hodo		1963

Tiranë	PANDI KRISTO	1028	115
Korçë	Gani Bega		200
Korçë	Gani Bega		1902
Korçë	Afize Kajtazi, Ismail Kajtazi	2881	7783
Gjirokastër	Hydari Brahollari		1190
Korçë	Gani Bega	610.5	313.5
Korçë	Gani Bega		200
Korçë	Gani Bega		1902
Durrës	Izet Ademi	190	260
Durrës	Mark Bala		84
Durrës	Genc Guri		31.2
Elbasan	Rexhep Çarçiu		4157
Elbasan	Zenel Zani		1360
Elbasan	Mustafa Balliu	8032	7233.5
Elbasan	HEKURAN SHQIPJA		2100
Gjirokastër	Dhimiter Lamani		69
Gjirokastër	Hance Gogollari		2621
Gjirokastër	Mehmet Canaj		1898
Kukës	Ahmet Kloka	300	300
Gjirokastër	Dragua Reshat Shehu	5000	6900
Gjirokastër	Xhevit Duro	410	1178
Berat	Nazif Osmani		2000
Berat			1200
Berat	Zeni Levenishti		470
Berat	Karafil Arapi		1000
Dibër	BAJRAM IMER DUKA		1080
Dibër	SELIM ALI KURTI		900
Dibër			182
Dibër			2117
Dibër			1018
Dibër			978
Durrës	Hasan Karagiozi		611

Durrës	Sali Sala		111
Fier	Asllan Xhebexhiu	5000	5000
Fier	Jorgjia Doga		7490
Fier	Ligor Ndini		4000
Fier	T AFIL HOXHA	2259	3741
Fier	KADRI HOXHA		7000
Fier	Ramazan Cela		10500
Fier	Ismail Arapi		10000
Fier	Irakli Papa	300	20580
Fier	Izet Buzi		350
Fier	Ismail Tabaku		4000
Fier	YMER HYDI	4000	7200
Fier	Vasip Arapi		10100
Fier	Tuni Jorgo	4400	6000
Fier	ZOI SOTA	4496	1710
Fier	Themet Perriu		1000
Fier	ARQILE RRUDHA	1100	4300
Fier	THEODHOR LALA		9200
Fier	LLAZI KOTE		8000
Fier	Hajrulla Halleshi		3000
Fier	Xhafer Cela		5500
Fier	FANI NDONI	2640	9160
Fier	Qerim Libohov		14200
Fier	Figëret Ismailati		13700
Fier	Xhevdet Xhindoli		10500
Fier	T AJAR HASANBELLIU		10700
Fier	Reshat Xhindole		10600

Fier	ISUF MEZINI	4000	2310
Fier	HAMIDE KORRESHI		11000
Fier	Hekuran Manko	7000	3600
Fier	Shaban Shazivari		5000
Fier	PALI JORGJI		13734

Fier	JORGJI VELO	1600	2505
Fier	Ilmi Lecini		10100
Fier	Themi Loshe		8800
Fier	Halit Murrizi	816	2104
Fier	MUSTAFA MURRIZI		2400
Fier	Liman Sopjani		4585
Fier	SALI POCI	10000	6000
Gjirokastër	Cane Muharremi	5000	4546
Korçë	Ivaner Kello	472	28
Korçë	Agim Isai		3356
Korçë	Selman Çerçizi		340
Korçë	Ervehe Laho		320
Korçë	Tahir e Pellumb Tahiri	1753.5	3958.5
Lezhë	Fatmir Dervishi		51850
Shkodër	Halim Osmani		10300
Fier	Bajram Coku	1960	8040
Fier	Mentor Kurti	5000	5000
Fier	Miti Balashi	3400	1860
Fier	Adem Mezini		6150
Dibër	Hazis Tahir Tola		1170
Durrës	Vath Rameta		519.17
Elbasan	RESHIT KOKONOZI	1831	8449
Gjirokastër	Riza Rizai		3043
Korçë	Gaqo Pengo		84.5
Kukës	Salih Murat Mici		2400
Kukës	Qerim Gjahu		1100
Tiranë	SHABAN XHAHYSA		787.5
Vlorë	Violeta Kate		400
Vlorë	Niqit Lame		627
Tiranë	Jashar Xhameta		0

Tiranë	LORENC MULLAJ IBRAHIMI	1092.4	1811.6
Gjirokastër	Eranda Shehu	2950	17780
Durrës	Kosta Kutulla		4199
Shkodër	Ahmet Bekteshi		1246
Korçë	Zarif Spaho	12415	5827
Korçë	Myrvete Spaho	14985	5827
Korçë	Vllazëria Çollaku	1082	387
Korçë	Gezim Isaku	104.2	89.5
Korçë	Violeta Zhuri	148	198
Korçë	Marike Mike	5000	6638
Korçë	Arsinoi Joti	5000	5319
Tiranë	ISMAIL VESHI	206	855
Vlorë	Alim Alushi	2835	450
Korçë		750	450
Tiranë	ALI SEFERI	675	391.5
Vlorë	Refat Puto	3902	147000
Vlorë	Nurije Gota	9519	66000
Korçë	GANI BYLYKU	1005	845
Korçë	Muharem Shkëmbi	126	574
Berat	Asllan Domi		25000
Berat	Fetah Karemani		16500
Korçë	Zhaneta Pojani		2000
Korçë	Domka Qam Kendezi, Nevruz Qam Kendezi		390
Korçë	Gaqo Cingo		524.9
Korçë	Mimoza Leco	33.75	167.55
Korçë	Petrika Nasa	125	10955
Korçë	Eqerem Sade		75
Korçë	Sulejman Malaj	936	397
Korçë	Dhimiter Peco		1311
Korçë	Lumturi Pupa	1050	3450
Korçë	Dhosi Koki		10860
Korçë	Dhosi Koki		720
Korçë	Statha Sofi		0

Vlorë	Shefki Mezini		5000
Vlorë	Eftimi Pozio		2530
Vlorë	Nasho Qirko, Telemek Qirko		0
Korçë	Petrika Nase	800	1840
Korçë	Barjam Saliu		30
Vlorë	Eftimi Pozio		2530
Korçë			5300
Korçë	Jetnor Haxhi Myrto	879	94
Korçë	Merjeme Cenolli	311	2326
Korçë	Gjike Sumbulla		2492
Korçë	Liri Kadillari		700
Korçë	Tefik Doko	64	341
Korçë			5930
Vlorë	Masar Ballaci	6307	1693
Vlorë	Sanije Baxho	8521	3679
Vlorë	Nedina Shena	2242	858
Vlorë	Sihat Bajo	2151	2479
Korçë	Ramadan Lilolli		1250
Vlorë	Agron Dracuna, Pircezi Dracuna, Elmas Bequlla, Haxhi Bequlla	2950	2336
Durrës	Vaide Hoxha		208.5
Durrës	Eleni Peti		797
Korçë	Rubije Lipe	1490	1110
Korçë	Muharrem Musa	56	770
Korçë	Hajrije Zerja		521
Korçë	Xhafer Mehmeti		168
Korçë	Nedine Shupe		1765
Korçë	Veiz Prodani		1093
Gjirokastër	Hafize Gjata	8784	916
Korçë	STAVRI AFEZOLLI	176	33
Lezhë	Roza Ljarja		992
Lezhë	Njazi Zyberi		1216
Tiranë	GENC KRYEZIU	598	464.5
Durrës	Shkelqim Kulla	870	330
Lezhë	Shtefen Gjeto Markgjonaj		6000
Korçë	Theodhora Plaku	220	800
Korçë	Dhimo Krali		214
Korçë	Theodhora Plaku	220	800
Tiranë	Nurije Mati		97672
Tiranë	HYSEN SHEHU		73.75
Tiranë	Qanije Tafa	20	6583
Durrës	Xhevdet Balla		300
Durrës	Nexhmin Sako		0
Durrës	Tofik Kokomani	12660	6734
Korçë	Muhamer Topalli	1800	721
Korçë	AGIM SHKEMBI		400
Korçë	Skender Shkaba		500
Korçë	Fitret Sarxha	360	915
Korçë	Albert Zhgaba		500
Korçë	Pavlo Ropi	53	3000
Korçë	Meri Suljoti (Karenxhi)		126.75
Korçë	Anesti Lako	144.2	0
Korçë	Koco Mano		1476.5
Korçë	Vasilika Jani		60
Tiranë	RAMAZAN T ABAKU	1174	781
Korçë	Vasil Jorgji	572	1852
Korçë	Mirdash Fero	2310	350
Durrës	Zenun Alizoti		300
Vlorë	Sanije Baxho	2071	4491
Gjirokastër	Atdhe Bejleri	3829	2028
Korçë	Bujar Shehu	5060	5995
Tiranë	Sali Egro	30	240
Durrës	Rifat Mecja		10158
Korçë	SELAM SHEHU	1200	800
Tiranë	VERA ZHEJI		720
Tiranë	Rubije Fasliu	57	633.4
Tiranë	AGIM PETRELA	4832.5	3429
Gjirokastër	Sazan Hamiti		2563
Shkodër	Dan Dervishi Hasanaj	4960	1140

Shkodër	Zef Curra		6000
Shkodër	Liza Jubani		250
Shkodër	Vahid Halluni	4120	2894
Tiranë	FIQIRI, QAZIM ASLLANI	183.5	191
Korçë	Makbule Gjiriti	1377	923
Korçë	Qamil Hasani		1036
Korçë	Hatixhe Bejko		3579
Korçë	Kosta Milo	368	153
Korçë	Afroviti Prifti	221	99
Korçë	Tasi Qirjo	267	195
Vlorë	Silvana Naçi	2775	3030
Vlorë	Fatime Bubeqi		300
Vlorë	Vilasi Thomai		252
Vlorë	T trashgimtaret Bataj		600

Vlorë	Jaho Jahja	7705	275
Vlorë	Minella Mone		2500
Shkodër	Zef Mark Gocaj		1500
Shkodër	Broz Gjon Gocaj		1500
Shkodër	Ferit Prroi		9200
Shkodër	Selman Kamber Laci		250
Korçë	MESEN HYSENI	928	1522
Korçë	Bajram Kodrasi	2896	460
Korçë	Viktor Kaçiroti	1155	9020
Korçë	Verter Mara		4000
Korçë	Petrike Konomi		0
Korçë	Viktori Dhima		30.25
Tiranë	OSMAN YMER TAKU	2732	0
Tiranë			0
Durrës	Lutfi Veseli	250	326
Durrës	Muharrem Shani	1201	150
Durrës	Haxhi Shani	696	650
Korçë	Agron Minarolli	1146.3	872
Tiranë		17249	1347
Tiranë			19870
Vlorë	Shaban Mino	256	1289
Fier	Gjergji Gjini	1225	2545
Fier	Thoma Dhama		2500
Fier	Arife Qosja		4750
Fier	Minushe Shazivari		8000
Fier	Ristan Stasa		11200
Fier	Asqeri Senka	2360	640
Fier	Grigora Robo	1940	13160
Fier	Muharrem Fisha		2000
Korçë			1340
Korçë	Ali Mydin		700

Korçë		2025	3635
Korçë	Guradem Isallari	750	2810
Tiranë	QEMAL E VELLEZLIK		6599
Tiranë	ELI VEIZI, Fatime veizi, Nexhije Veizi	412	1596
Tiranë		2356	493
Tiranë	SKENDER VEIZI	900	732
Tiranë	URAN ASLLANI		682
Fier	Hakik Xhumari		5800
Korçë	Seit Latif	290	810
Korçë	Ylvije Diko		1134
Elbasan	BASHKIM ÇELIKU	6500	900
Korçë	Donika Qani Këndezi, Nevruz Qani Këndezi		1130
Korçë	Donika Qani Këndezi, Nevruz Qani Këndezi	256	446
Korçë	Donika Qani Këndezi, Nevruz Qani Këndezi		0
Tiranë	SYRJA KURTI	120	30
Korçë	Gani Bega	875	567
Korçë	Gani Bega	875	567
Korçë	Gani Dede		2400
Korçë	Muhamet Prespa		11432

Ksenofon Krisafi

# NJË LIBËR ME VLERA TË SPIKATURA

## Paraja, bankat dhe shoqëria, i profesorëve Anastas Angjeli dhe Aristotel Pano

Kushdo që ka pasur rastin të vizitojë muze historike mund të ketë parë në stendat e tyre monedha të madhësive, formave dhe prerjeve të ndryshme. Natyrshëm mund t'i ketë lindur pyetja kur, ku dhe nga kush është hedhur ideja e përdorimit të parësë, monedhës, si mjet për lehtësimin e shkëmbimeve ndërmjet njerëzve, si faktorë të rëndësishëm zhvillimit ekonomik e shoqëror? Kur dhe ku u vu për herë të parë në qarkullim paraja, si dhe, kur dhe ku u hap banka e parë? Këto pyetje dhe shumë të tjera që lidhen me çështje të tilla marrin përgjigjen e duhur në librin "Paraja, bankat dhe shoqëria", veprë e dy profesorëve të shquar të shkencave ekonomike dhe financiare, prof. dr. Anastas Angjeli dhe prof. dr. Aristotel Pano. Libri i tyre ka dalë në qarkullim këto ditë nga UMSH-PRESS.

Do ta quaja privilegj për lexuesin t'i marrë përgjigjet për pyetjet e mësipërme dhe të fitojë disa njohuri dhe dije profesionale për këto tema nga autorët e lartpërmendur, të cilët kanë një veprimtari të gjatë dhe të vyer akademike dhe kërkimore-shkencore. Atë e kanë konkretizuar në ligjërimin si pedagogë në universitetet të ndryshme publike e jopublike, brenda e jashtë vendit, si dhe në botime të shumta monografike, të mirëpritura e të vlerësuara me konsiderata pozitive. Në listën e botimeve të prof. Angjelit renditen libri voluminoz Ditari i tranzicionit ekonomik. Në ethet e krizës, Tranzicioni dhe liria ekonomike në Shqipëri/Transition and Economic Freedom in Albania, Hyrje në ekonomi, Shqipëria-ekonomia, aspiratat e saj për integrimin rajonal dhe euro-atlantik, Tiranë, Financat publike në Shqipëri, Financat publike, Financat dhe Krediti, Ekonomia bankare, Sektori financiar i tregtisë, Marrëdhëniet ndërkombëtare ekonomike dhe financiare, Bursa, Marrëdhëniet ekonomike - financiare të shtetit me sektorin e bujqësisë etj. Ai ka edhe një numër tjetër botimesh në bashkautorësi me kolegë, ndër të cilat spikatin ato me bashkautorin e këtij botimi, prof. Pano, siç janë katër vëllimet e librit Ligjëratat Nobel në ekonomi, (2003-2005) dhe Ndërhyrja e shtetit në Ekonomi, (2015) si dhe Hyrje në ekonomi (2010), Mikroekonomia (2010) dhe Marketingu bankar (2010), disa të tjera në bashkautorësi. Prof. Angjeli është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Akademisë Europiane të Arteve dhe Shkencave. Prej rreth tri dekadash është i angazhuar aktivisht në politikë si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ministër i Financave, Ekonomisë si dhe i Punës etj.

Mjaft e gjatë është edhe lista e botimeve të prof. Panos, i cili është konsideruar nga kolegët dhe studentët e tij si një ndër ikonat e mendimit ekonomik shqiptar. Gjatë viteve 1955-2019 ka botuar libra, monografi, studime dhe artikuj shkencorë për çështje që kanë të bëjnë me analizën ekonomiko-financiare, kontabilitetin, financat dhe shkencën ekonomike në përgjithësi. Midis tyre përmenden veçanërisht librat Fjalor ekonomik - financiar, Analiza e veprimtarisë ekonomiko-financiare të njëjës ekonomike të biznesit, Karl Marks: nga shkenca në utopi: meditimet e një ekonomisti, Inflacioni-sëmundje kronike e botës kapitaliste, Probleme të teorisë, të metodologjisë dhe të analizës së ardhurave kombëtare në RPSSH etj.. Prof. Pano është përkthyes i librave Nobelistët e shkencës ekonomike, (2002), "Epoka e trazirave", të Alan Greenspan, përkthyes i një përmbledhjeje studimesh nga autorë amerikanë për krizat e mëdha botërore etj.

Produkti i formimit dhe përvojës së pasur të tyre është edhe libri më i fundit, ku trajtojnë funksionin rregullativ dhe ndikimin e parësë dhe bankave në tregtinë dhe ekonominë. Vështrimi i autorëve shtrihet edhe më gjerë e më thellë se kaq, duke vendë dukje gjithashtu rolin e tyre në iden-

tifikimin e përkatësive kombëtare, kulturore, si dhe në zhvillimin, progresin ose rënien e shteteve. Sipas tyre edhe hapësirat iliro-shqiptare kanë pasur gjithashtu një histori interesante monetare e bankare, që nis nga lashtësia, prej fillësive të organizimeve të para politike.

Libri është edhe një lloj historie e përgjithshme e njerëzimit, por një histori siu generis, sepse është parë në optikën e historisë së parësë dhe bankave, të cilat janë tregues domethënës të zhvillimit shoqëror. Në rrugëtimin e gjatë historik drejt mirëqenies, progresit, garantimit të sigurisë ekonomike dhe financiare permanent njeriu diti të përdorte me mençuri në dobi të tij jo vetëm pasuritë natyrore, por edhe idetë, realizimet tekniko-shkencore dhe në përgjithësi dijen njerëzore. Një prej shpikjeve interesante dhe dobipëruese ishte vënia në përdorim e parësë, të cilën libri e trajton si një rris të kohës kur u shfaq për zhvillimin e të mirave dhe shërbimeve për përmirësimin e jetës.

Libri ka një karakter të spikatur enciklopedik në fushën e parësë, bankave dhe zhvillimeve sociale. Fokus i tij përqendrohet të shfaqja dhe evolucioni i parësë, monedhës, si mjet për realizimin komod të shkëmbimeve ndërmjet njerëzve në shoqërinë e organizuar politikisht. Njëpër një inkursioni të gjatë në historinë e shoqërisë njerëzore autorët e shoqërojnë lexuesin për gjatë pothuajse tremijë vjetësh në hapësira, që përfshijnë gati gjithë rrugullin, ku provohet se paraja lindi si domosdoshmëri, si formë shkëmbimi, pikërisht atëherë kur njeriu nuk i gjente të gjitha zgjidhjet e dëshuruara në "shkëmbimet me gishta". Autorët mbështesin idenë e pranuar tashterë nga shumica e studiuesve të kësaj fushe, se lindja dhe ecuria e sistemeve monetare dhe bankare ishin pasojë e zhvillimit dhe njëkohësisht rregullimit institucional të marrëdhënieve mall-para. E vështruar në funksion të rolit që ka luajtur në zhvillimin e shoqërisë, përmes një vargu të dhënash dhe faktesh, ngjarjesh dhe zhvillimesh, paraja prezantohet si një prej realizimeve më të mëdha të njerëzimit, me rëndësi dhe mision të posaçëm. E tillë konsiderohet edhe banka, institucioni kryesor i parjesë, emetimit dhe administrimit të saj dhe në përgjithësi sistemeve monetare. Paraja është jo vetëm instrument për nxitjen e zhvillimit ekonomik e shoqëror të njerëzimit, por edhe mjet për shmangien e turbulencave politike dhe konsolidimin e shteteve.

Të dhëna që vijnë nga shkrime mbi pllaka guri, metali ose pergame, nga rezultatet e zbulimeve arkeologjike dhe nga punimet të autorëve antikë, flasin për rrugëtimin e gjatë e të vështirë duke nisur nga "paraja primitive", fenomen i shfaqur dhe i ndeshur pothuajse në të njëjtën kohë në të gjitha oazet e jetës ndërkombëtare të globit, ku ajo ka prezantuar karakteristika dhe funksione të njëjta. Ato tregojnë se në një etapë të caktuar të zhvillimit, u lanë pas shkëmbimet në natyrë, si mënyra të papërshtatshme për të përballuar nivelet, format dhe volumet e rëndësishme të tregimit të mallrave. Autorët, për të shuar kuriozitetin e lexuesve, iu referohen veprave të numizmatëve, të cilët kanë konkluduar se monedha e parë metalike u vit në Lydia të Azisë së Vogël, në vitet 640-

630 para erës së re.

Libri tregon se edhe në kohërat kur nuk njihet dhe nuk përdorej emërtimi "bankë" në kuptimin e saj të sotëm, ekzistonte dhe ushtrohej veprimtari bankare. Në objektet e kultit, në tempujt e lashtësisë në Mesopotami, Babiloni etj., kryeshin operacione të tilla që në thelbin i tyre klasifikohen si veprimtari bankare. Gjurmët e gjetura flasin gjithashtu për pranimin e tërheqjes së depozitave të produkteve të veçanta, për shlyerjen ose pagimit të detyrimeve, nëpërmjet regjistrimit të xhirimeve në sasi

sosistikuara, tipike të epokës së globalizimit.

Krijimi i Euro-s, si monedhë e BE, së bashku me funksionin e Bankës Qendrore Evropiane përbëjnë zhvillime cilësore për inkurajimin dhe lehtësimin e progresit ekonomiko-shoqëror.

Nga vështrimi i tyre i gjithanshëm dhe përgjithësues autorët kanë dalë edhe në konkluzionin se paraja, në raste të caktuara, ka shoqëruar ushtritë dhe administratat pushtuese dhe ka shërbyer si armë mbështetëse për invadimin e popujve të sulmuar, si "armë" që iu bashkua pushtimit dhe shtrirjes së ndikimit të gjuhës, kulturës, artit, ideologjisë, fesë, zakonëve, traditave etj.

Autorët kanë theksuar dhe shtjelluar me mjaft elegancë të vërtetën e madhe se projektet për prosperitet dhe stabilitet ekonomik shkojnë paralel me projektet për zhvillimin e parësë dhe formave të saj, si dhe për përmirësimin e sistemeve monetare. Ato përfaqësojnë instrumente institucionale të rregulluara juridikisht në formë të tilla që, për t'i shërbyer progresit ekonomik e social, duhen respektuar rigorozisht. Cenimi ose dhunimi i filozofisë së tyre vepruese ose i kornizave juridiko-institucionale, jashtë mbështetjes së nevojshme ekonomike, për të financuar luftëra ose përballuar lëndunde buxhetore, rrjedhojë e politikave të gabuara, çojnë në nivele të larta inflacioni dhe në situata



të produkteve natyrore etj.

Për të kuptuar madhësinë e asaj që njeriu ka arritur në këtë fushë veprimtarish, autorët ndalen edhe të hapat që çuan në krijimin e të parësë bankë në kuptimin e mirëfillt të fjalës, ngjarje që u vërtetua në mesjetë, në kohën e kryqëzatatave, kur për të ruajtur pelegrinët nga grabitësit, u themelua Banka e Tempullarëve. Në vijim u krijuan bankat e kreditit Lombard, banka private të tregtarëve italianë, banka publike e Amsterdimit, Banka Qendrore e Holandës, Banka e këmbimeve të Suedisë, Banka e Anglisë etj. U çel epoka e krijimit të bankave qendrore dhe emetimit të bankënotave të konvertueshme, që përbën një hap substancial në veprimtarinë bankare si hap i rëndësishëm i procesit transformues ekonomik e financiar që do të përmirësohej më pas. Procesi i zhvillimeve progresive, rrjedhojë e padohshimit e arritjeve ekonomike, sociale e politike në shtete të ndryshme, kërkoi ndërhyrje të tjera më të thella që çuan në modernizimin dhe lehtësimin e sistemeve financiare e bankare. Ndikime të ndjeshme pati konferenca e Breton Woods, e vitit 1944, e cila kontriboi në hedhjen e themeleve të sistemit monetar ndërkombëtar dhe institucioneve përkatëse të periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore. Të tilla ishin FMN, BB, GATT, COBT etj. filozofia dhe veprimtaria e të cilave i hap i rrugën sistemit të sotëm modern, formave të

paqëndrueshmërie monetare e financiare. Pasaot, siç theksojnë edhe autorët, mund të jenë të paparashikueshme për stabilitetin afatgjatë makroekonomik e financiar. Kjo është provuar në jo pak raste. Prandaj duke u njohur, nëpërmjet këtij libri me historikun e zhvillimit të parësë dhe të bankave, me arritjet por edhe me zhvillimet e trishita të së kaluarës, specialistët e fushës, sikurse edhe politikëbërësit kanë mundësinë të orientohen më mirë për të përgjigdhur dhe zbatuar sistemet dhe metodat e duhura për administrimin bankar e monetar, për shmangien e veprimeve të papërgjegjshme ose të ndërhyrjeve arbitrare të politikës në sistemet monetare e financiare, për të garantuar sigurinë e konsumatorëve dhe të sistemit financiar, stabilitetin e çmimeve dhe atë ekonomik etj.

Në këtë kuptim libri fton për kujdes maksimal. Veçanërisht në kohën tonë, kur kufijtë shtetërorë janë shndërruar në vija virtuale, trajtimi me seriozitet dhe përgjegjshmëri i politikave financiare e bankare dhe operacioneve për zbatimin e tyre, ndihmojnë në shmangien e situatave problematike, sepse ato mund të degradojnë në kriza të rënda financiare, të cilat, pikërisht edhe për këto shkaqe, janë bërë tashmë një fenomen që përsëritet gati në mënyrë ciklike. Duke iu referuar precedentëve negativë më tipikë nga kohë dhe vende të ndryshme autorët insistojnë

se duhen dekurajuar ndërhyrjet e pamotivuar për rregullime artificiale të deficiteve buxhetore, për sigurimin në forma të paligjshme të burimeve financiare për zhvillimin e fushatave elektorale ose më keq akoma për shpërbërjen e luftërave agresive etj.

Në një pjesë të librit të tyre, Angjeli dhe Pano, përshkruajnë fenomenet e reja që shfaqen të paraja dhe sistemet monetare dhe vënë në dukje se ato afektjnë ekonominë, tregtinë, financat etj., jo vetëm në botën e zhvilluar por edhe në vendet në zhvillim, të cilëve iu imponojnë futjen e risive teknologjike edhe në kryerjen e operacioneve bankare e financiare. Janë të nxitura dhe të kushtëzuara nga progresi marramendës në fushën e automatizimit, teknologjisë së komunikimit dhe të informacionit etj. Zhvillime të tilla përjetohen edhe në Shqipëri, ku si kudo, evidentohen qartësisht edhe aspektet e tjera të parësë, me karakter social, institucional, kulturor, edukativ etj.

Autorët insistojnë me të drejtë se, sidomos në kushtet e reja, edukimi financiar merr një rëndësi të veçantë. Kjo jo vetëm për publikun, por edhe për autoritetet të cilët duhet të përcaktojnë rregullat e ndërveprimit për të garantuar sigurinë e konsumatorëve dhe të sistemit financiar së bashku me stabilitetin e çmimeve dhe atë ekonomik.

Kur mbyll faqen e fundit të këtij libri shumë të mirë, lexuesi do ta ketë më të lehtë të formulojë disa ide rreth përgjigjes për pyetjen se si do të jetë ecuria e parësë dhe e bankave?

Libri, siç e pohojnë edhe vetë autorët, është produkt i një pune të gjatë e të lodhshme, të kryer me përkushtim e pasion, gjatë një periudhe rreth dhjetëvjeçare. Duke e lexuar, bashkë me kënaqësinë dhe kuriozitetin të shoqëror pothuajse në çdo faqe, ke ndjeshmëri se në themelet e tij janë disa libra faqe botimesh serioze bibliografike me karakter historik, politik, ekonomik, financiar, bankar etj., të shkruara nga historianë, arkeologë, numizmatë, ekonomistë, financierë etj., që kanë sjellë kontribute në këto fusha. Gjithë kjo "lëndë e parë" e grumbulluar në "kantinën krijuese" të profesorëve të nderuar Pano e Angjeli është shqyrtuar dhe analizuar me kujdes e skrupulozitet shkencor, analizë përmes të cilës autorët kanë përpunuar idetë, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre në fushën e parësë dhe të bankave, të cilat i kanë shprehur në mendime, teza dhe konkluzione interesante, me një gjuhë të përpunuar, të qartë dhe të kuptueshme.

Libri Paraja, bankat dhe shoqëria, i profesorëve Anastas Angjeli dhe Aristotel Pano është një kontribut i çmuar për edukimin e specialistëve të fushës me dije të thelluara dhe me një kulturë të gjithanshme profesionale. Ai përfaqëson një studim të mirëfillt shkencor me risi të shumta. Dallohet për horizontin e gjerë kulturor, kompetencën e admirueshme profesionale të autorëve, shtjellimin shumëplanësh, mbështetur në një literaturë voluminoze profesionale.

Përbërja e librit, e përkthuar nga probleme madhore, paraqitën një formë interesante dhe me stil tërheqës, e bëjnë librin shumë të dobishëm edhe për pedagogët e fakulteteve të ekonomisë dhe për studentët e tyre, për transmetimin e njohurive të qëndrueshme në shkencat ekonomiko-financiare.

## SHFAQJA

# Antigona si model kryengritjeje, të flesh a të flijohesh

Fatmira Nikolli

-Ajo që duhet të diskutojmë ne, është nëse do ta bëjmë apo jo, por nëse do të bëjmë, do e bëjmë kështu.

-Pse?

- Sepse një mëngjes u zgjova dhe isha mbret i Tebës dhe një Zot e di, në ka një jetë tjetër për të qenë kaq i fuqishëm".

Vetëm pak fraza nga dialogu mes Antigones dhe mbretit Kreon, shpërfaqin konfliktin e madh të një shfaqjeje: transformimi që i bën pushteti njeriut. Skena është e zhveshur dhe metali (skenograf Beqo Nanaj) që kërcet përçon vetëm ftohtësinë e një tragjedie të kobshme. Ndonëse më herët u tha se shfaqja është sjellë në vitet e Luftës së Dytë Botërore, përtej kostumeve (kostumografe: Sofi Kara) të dy rojeve, asgjë nuk e lidh me një kohë të caktuar, as xhupi lëkure i Hemonit, as fustani i bardhë i Antigones që gjithaq të lidh sa me tragjeditë greke edhe me motivet shqiptare. Duket madje se krijohen kërcitje, nga veshja e Antigones tek ajo e Hemonit, a nga veshja e Kreonit me këngën e Lady Gagës dhe Bradley Cooper "Shallo". Aktorët jo gjithnjë arrijnë të mbajnë mbi supe peshën e tekstit por rrëfimtari Romir Zalla me Laura Nezhën (Antigona), Ervin Bejlerin (Kreoni), Xhino Musollarin (Hemoni), Xhulia Musagalliun (motra e Antigones), Adriana Tolkën (mendësja) Klejdi Metajn dhe Endri Çelën (dy rojet) krijojnë trupin lëvizës të një shfaqjeje ku tragjedia ngre krye. Sikundër ka skena ku peshat e tekstit shpërfilllet nga tonaliteti i interpretimit dhe vrapit nëpër qoshtet e skenës, ka edhe skena kur britmat a interpretimi ia dalin të mbërthejnë publikun. Zalla si rrëfimtari, Bejleri si mbret tiran, Antigona si heroinë, e motra si njeri që ka mposhtur frikën, ushtarët që zbatojnë urdhrat dhe mendojnë për femijet e tyre, në 1 orë e 30 minuta, ia dalin ta përçojnë botën e personazhit që personifikojnë.

E shpesh peshën e tragjedisë, më shumë se askush, e përçon muzika e Stephan Zacharias "Hoffnung Am Ende Der Welt". Antigona që po vihet në skenë në Teatrin Eksperimental është bazuar në tekstin e Jean Anouilh, përktim i Ekrem Bashës me regji të Andrea Brusque. I ka humbur disa prej elementëve dhe konf-



likteve të Sofokliut. Por lufta e një 'heroine' për të varrosur të vëllanë, lufta e një heroine që 'ligjet hyjnore' të dalin mbi ato shtetërore, përcillet. Është mbi të gjitha jeta e ndërmjetme e atij që ngre krye, nga çasti kur kupton në se beson, deri të dita kur para se të vdesë, e ndjen edhe njëherë 'tundimin e fundit'.

Historia e shfaqjes është thjeshtëzuar: Mbreti Kreon ka dhënë urdhrë që prej dy vëllezërve të vdekur në luftë, Etoklit dhe Polinikut, i pari do të përcillet për në banesën e fundit me ceremoni si hero, ndërsa i dyti, nuk meriton të varrosset- ai do lihet mbi dhe, duke qenë i ekspozuar ndaj shpendëve grabitqarë- që erën rëndë të trupit që dekompozohet ta ndjejë si mbreti dhe qytetarët. Ata duhet të kujtojnë se çfarë ka ndodhur. Duhet të përcillet në Tebë, ligji dhe frika ndaj mbretit. Sepse mbreti ka vendosur të thotë po dhe prej asaj dite është bërë peng "po"-së dhe ka fshirë çdo gjë e çdo kënd për hir të ditës kur tha po.

Shumëçka tjetër nga tragjedia, si 'kompleksi i Edipit', incesti, a djali që vret babain e shkome nënën, i luftës së dy vëllezërve për pushtet janë

*Shfaqja në Teatrin Kombëtar Eksperimental, si lexues i sjelljeve politike*

"Unë, nuk dua që të vdesësh për një histori politike. Çfarë kujton ti moj, që nuk më vjen keq për atë trup që po kalbet në mes të diellit?", - shqipton mbreti kur i lutet mbesës të heqë dorë nga varrimi i vëllait.

shkruirë për të nxjerrë krye vetëm një e vërtetë, që mbajtja e pushtetit nuk nje limitet, as nëse pushtet-mbajtësi, mbetet i vetëm në majën e lartë, as nëse s'ka më me kë ta gëzojë pushtetit, as kur humb të tijtë, as kur i dënon të tijtë.

Kundër urdhrat del Antigona, motra e Polinikut e cila beson se i vëllai meriton të varrosset. Kur rojet e Kreonit e zënë duke e mbuluar trupin e pajetë me dhe, me një dhe që gërryhet me thonj, mes mbretit dhe mbesës që është njëherësh e



fejuara e djalit të mbretit vihen përballë dy botë: ajo e pushtetit dhe ajo e kryengritësit. Ajo e njeriut që bën çdo gjë për të mbajtur pushtetin dhe ajo e njeriut që dorëzon çdo gjë, rehatinë, luksin, dashurinë dhe vetë jetën për hir të asaj që beson. Vihen përballë dy besime, ai i burrit që mendon se për pushtetin vlen gjithçka e ai i njeriut që mendon se pa dinjitetin nuk vlen asgjë. Jaç përballë mbreti Kreon dhe e

bija e Edipit.

Shpesh është vetëm një vijë e hollë që e ndan heroin nga tradhtari, shpesh është pothuaj e padukshme ajo vijë e hollë që i ndan heroïn nga antiteza e tij. Shpesh e bardha është vetëm një shtresë boje larg nga zeza.

"Unë gjeta dy kufoma të përqafulara. Mbase është herë e parë që përqafoheshin pas kaq kohësh. Të dy donin ta rrëzonin nga fronti të atin. Nëse njëri e

"Unë gjeta dy kufoma të përqafulara. Mbase është herë e parë që përqafoheshin pas kaq kohësh. Të dy donin ta rrëzonin nga fronti të atin. Nëse njëri e arriti i pari është vetëm çështje kohe.

arriti i pari është vetëm çështje kohe. Kur i gjeta, mezi njiheshin. I mora dy trupat dhe njërin e shpalla hero e tjetrin tradhtar". Kur mbreti Kreon mbaron së shqiptuari këto fjalë secili mund të kërkojë në kujtesë, për të gjetur tradhtarët e heronjtë e shpallur të tillë për hir të kulisave të çastit. Sepse janë shfaqje si kjo, të cilat prej antikitetit deri sot, përsërisin vetveten dhe realitetet, si modele pushtetesh, si pretekste për emrin e drejtuesit. Sepse janë shfaqje si kjo që e heqin pendën e kadhifentë të ëndrrave të thurura mbi beze, për t'ju vënë gjërave emrin që kanë dhe për ta drejtuar gishtin nga fajtori. Ka shpesh një fabul të dyshimtë përtej emrave që na brohoriten me të madhe.

Ne mundemi të flemë gjatë, por pasi ta dimë të vërtetën. Dhe nëse flemë, nëse ndërgjegjia na lejon të flemë edhe pasi e dimë të vërtetën, ne e meritojmë gjumin. Sepse ka gjithnjë dy rrugë, të flesh ose të flijohesh. Nuk ka të mesme. Njerëzimi është i destinuar të zgjedhë pafundësisht.

"Unë, nuk dua që të vdesësh për një histori politike. Çfarë kujton ti moj, që nuk më vjen keq për atë trup që po kalbet në mes të diellit?", - shqipton mbreti kur i lutet mbesës të heqë dorë nga varrimi i vëllait. Revolucionet janë të dhimbshme. Ato e hanë kokën e të bijve. Por ka gjithnjë një çast që zgjedh në atë që beson. Nëse vdekja nuk është zgjedhje, a do të ishte jeta? Dhe a është jetë ajo që pa dinjitet apo ajo kur i ke humbur të gjithë? Kjo është pyetja që secili i bën vetes.

E DIEL

17 Mars

2019



Vitin e kaluar u botua në shqip libri me autor historianin polak, teologun dhe filozofin, profesorin e Akademisë IGNATIANUM të Krakovit, Stanisław Cieslak SJ (Stanisław Cieslak) me titull "Ndre Mjeda dhe jezuitët e tjerë të Provincës së Venecies në Krakov".

Historiani i njohur polak Tadeusz Czekalski (Tadeusz Czekalski), autor i shumë librave për


Historinë e Shqipërisë, profesor në Universitetin e Krakovit, ka shkruar Recenzën e mëposhtme për këtë libër, botuar në fund të vitit 2018 në BALCANICA POSNANIENSA, nr. XXV, botim i Akteve Shkencore të Universitetit "Adam Mickiewicz" të Poznanit.

#### RECENZË

**e librit me autor Stanisław Cieslak me titull: "Ndre Mjeda dhe jezuitët e tjerë të Provincës së Venecies në Krakov", përkthyer në shqip nga Leonard Zissi, botuar në Tiranë në vitin 2018.**

**K**ohët e fundit, në sajë të një pune intensive të bashkëpunimit kulturor polako-shqiptar, në raftet e librarive shqiptare kanë dalë shumë publikime që u krijuan me iniciativën e mjedisit të shqiptarëve që në të kaluarën kanë qenë absolutë të Universiteteve polake, të cilët vazhdojnë të jenë plotësisht të angazhuar në promovimin e gjuhës dhe literaturës polake në Atdheun e tyre. Shumica e këtyre publikimeve janë iniciativa personale të përkthyesve shqiptarë, të cilat rrallë janë publikime të reja që do të ishin rrjedhojë e një bashkëpunimi të autorëve bashkëkohorë polakë dhe atyre shqiptarë. Një shembull i veçantë i një sipërmarrje të tillë të suksesshme polako-shqiptare është publikimi i ri i priftit jezuit Stanisław Cieslak, historian, teolog dhe filozof, profesor i Akademisë Ignatianum të Krakovit, veprimtaria shkencore e të cilit përmblodh një sërë publikimesh kushtuar historisë së jezuitëve, me theks kryesor veprimtarinë fetare të tyre lidhur me mjedisin e Krakovit.

Punimi i tij për pelegrinët jezuitë të Provincës së Venecies në Krakov, në periudhën 1881-1894, i cili për herë të parë u botua në gjuhën shqipe nga Shtëpia Botuese FLESH, është njëherësh edhe një shembull tjetër i bashkëpunimit të jezuitëve të Krakovit me përkthyesin Leonard Zissi. Në sajë të përpjekjeve të tij, tematika polake prej shumë vitesh është e pranishme vazhdimisht në shtypin dhe në raftet e librarive të Tiranës. Bashkëpunimi i jezuitëve të Krakovit me përkthyesin shqiptar e ka filluesën nga viti 2014, vit në të cilin u bë e mundur që lexuesi shqiptar të njihet me punimet e misionarit katolik polak Marcin Czermisski (Marcin Czerminski), që pak njëhjetë jashtë Polonisë, i cili në vitin 1893 botoi një nga publikimet e tij të para kushtuar Shqipërisë.



## HISTORIANËT POLAKË

Ju rrëfejme NDRE MJEDËN në Krakov

**Në këtë numër: TADEUSZ CZEKALSKI, KOSTANDIN RISTANI, ARIAN LEKA, MONIKA HASANI, ILIR KALEMAJ, ORJELA STAFASANI, ETJ...**

A

ARGUMENT

Vitin e kaluar u botua në shqip libri me autor historianin polak, teologun dhe filozofin, profesorin e Akademisë IGNATIANUM të Krakovit, Stanislaw Cielak SJ (Stanislaw Çieshslak) me titull "Ndre Mjeda dhe jezuitët e tjerë të Provincës së Venecies në Krakov".

Historiani i njohur polak Tadeusz Czekalski (Tadeush Çekalski), autor i shumë librave për Historinë e Shqipërisë, profesor në Universitetin e Krakovit, ka shkruar recensën e mëposhtme për këtë libër, botuar në fund të vitit 2018 në BALCANICA POSNANIENSA, nr. XXV, botim i Akteve Shkencore të Universitetit "Adam Mickiewicz" të Poznanit.


# Historianët polakë i kushtohen Ndre Mjedës

Vijon nga faqja 1

Nga Tadeusz Czekalski\*

Ky libër, ashtu si edhe botime të tjera të këtij autori që ishin relacione të tij nga ndhëtimet në Dalmaci, Mal të Zi dhe Bosnjë Hercegovinë, në përkthimin e Leonard Zissit, u bënë bestsellerë të tregut shqiptar të botimeve, duke konfirmuar njëkohësisht edhe origjinalitetin dhe vlerat e shoqërisë shqiptare që la pas vetes jezuiti i Krakovit 1).

Padyshim, inspirimi për botimin e këtij libri për të cilin po bëjmë këtë recensë, është publikimi në shtypin shqiptar nga L. Zissi i dokumenteve të Arkivit të Kolegjit Jezuit të Krakovit kushtuar Ndre Mjedës (1866-1937)2). Ky klerik, politikan dhe poet ishte një nga figurat më të spikatura të skenës politike shqiptare të viteve 20 të shekullit XX. Edukimi në tij e filloi në një familje shkodrane, për t'i vazhduar ato në shkollat dhe kolegjet jezuite në Valencë, Romë dhe Chieri në rrethinat e Torinos. Në vitin 1891, pas katër viteve të studimeve në Kremona, Ndre Mjeda erdhi në Krakov për të vazhduar në Kolegjin Jezuit të atyshëm dy vite studimesh për teologji. Pas largimit nga Krakovi, u emërua profesor në Kolegjin Jezuit të Kraljevicës të Kroacisë. Në vitin 1898, u largua nga Urdhri Jezuit dhe si klerik laik u përqendrua në shkollën më të lartë në veprimtarinë politike dhe pedagogjike3). Mjeda i përkiste grupit themeltar (bashkë me vëllain e tij, L Lazarin) të Shoqatës "Agimi" që patrononte botimin e dispencave dhe teksteve letrare në gjuhën shqipe. Gjatë punimeve të Kongresit të Manastirit në vitin 1908, Mjeda bënte pjesë në grupin prej 11 vetëve të Komisionit të Gjuhës Shqipe që përgatiti projektin e njësimimit të alfabetit të gjuhës shqipe4). Në vitet 1921-1925 Mjeda ishte deputet në Parlamentin Shqiptar, ku u angazhua në përgatitjen e akteve të reja juridike, përfshirë edhe Rregulloren e Punimeve të Parlamentit. Nga viti 1923, në sfondin e rritjes të krizës politike, u bë një nga figurat udhëheqëse të opozitës demokratike, të përqendruar rreth Fan Nolit. Në dhjetor të vitit 1924, pas rëzimit të qeverisë së Fan Nolit, Ndre Mjeda u tërhoq nga ve-



rimtaria politike, duke iu përkushtuar veprimtarisë letrare fetare. Nga fundi i jetës dha leksione për seminaristët në Kolegjin Papnor në Shkodër. Në vlerësimin e prodhimeve të tij të jetësore, një vend të rëndësishëm zë plotësimi i boshllëkut letrar, veçanërisht vëllimthi i tij i parë poetik me titull "Juvenilia" që i referohet stilit të poezisë italiane të shekullit XIX. Më pas, në vitet 20 të shekullit XX, botoi vëllimthet me tituj emrat e qyteteve të lashtë të Shqipërisë (Lissus, Scodra, Dyrrachium, Apollonia)5).

Përkthimi i periudhës të qëndrimit të Ndre Mjedës në Krakov në librin e Prof. S. Cielak, përbën një nga pjesët e biografisë së tij më të panjohur deri tani6). Pika

hyrëse për botimin e këtij libri për Mjedën dhe jezuitët e tjerë të Provincës së Venecies, u bë historia e disa dhjetra klerikëve të cilët, në fund të shekullit XIX, nga Provinca e Venecies u arsimuan në Kolegjin Jezuit të Krakovit, ku mbi njëzet prej tyre u shuguruan si priftërinj nga kardinali Albin Dunajewski. Në bazë të dokumenteve dhe dorëshkrimeve të grumbulluara në Arkivin e Shoqatës Jezuite të Polonisë Juglindore në Krakov, mund të studiohet pjesëmarrja e secilit student në leksione dhe debatet teologjike, si dhe formave të tjera të veprimtarisë të tyre si brenda mureve të Kolegjit, ashtu edhe në jetën publike.

Libri përbëhet nga Hyrja, shkruar nga përkthyesi, si edhe prej tri pjesëve të veçan-

ta7). Pjesa e parë i kushtohet historisë të prezencës së jezuitëve në Krakov nga fundi i shekullit XIX, si dhe përmblim informacione kushtuar qytetit dhe shoqërisë së tij. Pjesa e dytë paraqet historinë e kontakteve të jezuitëve të Krakovit me ata të Provincës së Venecies, përfshirë këtu edhe ato të dyzvet jezuitëve nga kjo Provincë të cilët studiuuan në Krakov8). Pjesa e tretë që është edhe pjesa më e madhe e librit, përqendrohet në situatën dhe zhvillimin e studimeve teologjike të Ndre Mjedës në Krakov. Kësaj i shërben paraqitja e programit të studimeve, ajo e siliuets së profesorëve të Kolegjit në formën e një fjalori biografik, si edhe veprimtaria e heroit të librit si pjesëmarrës në debatet teologjike. Në plotësim të panoramës të studimeve në Krakov, autori përshkruan gjithashtu programin e ekskursioneve për njohjen e rrethinave të Krakovit, që organizoheshin për klerikët gjatë kohës së lirë. Në libër nuk gjejmë konfirmim tezat e studimit të literaturës shqiptare të Robert Elsie-së se në Krakov Mjeda u njoh për herë të parë me veprat e filozofëve dhe albanologëve Gustav Meyer-it dhe Holger Pedersen-it, të cilët patën një ndikim të theksuar në veprimtarinë e tij poetike dhe letrare9).

Një recensë dinjitoze duhet të marrë parasysh edhe disa mangësi të një libri të botuar. Konceptin e këtij libri e përcaktonte masa e burimeve të të dhënave të grumbulluara, duke bërë prej tyre një fjalor biografik, shoqëruar këto me fotografitë e periudhës së shkollimit jezuit të Ndre Mjedës në Krakov. Një mungesë fotografish mund të jetë marginalizimi i një pjese deklamative që do të kishte një ndikim të rëndësishëm në rritjen e vlerave njohëse të këtij libri. Zgjedhja e gjuhës bazë të këtij libri të krijon bindjen se konsumatorët kryesorë do të jenë lexuesit shqiptarë. Duke marrë parasysh mungesën në tregun shqiptar të librave të historisë së Polonisë, publikimi i këtij libri për studimet e Ndre Mjedës në Krakov, krijon një situatë të favorshme që, nëpërmjet figurës së studentit shqiptar t'u afrosh në një masë të madhe bashkëkombasve të tij konteksin shkencor polak të pelegrinëve, si dhe paraqitjen e shoqërisë polake në mbarim të shekullit XIX. Forma përmblendhëse që autori ka trajtuar kontekstin e stu-

dimeve të Mjedës, mund të përbëjë një problem të qendrësishëm për lexuesit që e njohin pak historinë e Polonisë. Specifika e Krakovit si një qendër intelektuale, veçanërisht e rëndësishme gjatë periudhës së autonomisë që gëzonte në kuadër të Galicisë, të mundëson të gjykosh se studentët jezuitë, përveç debateve teologjike që bëheshin në një mjedis të mbyllur, u poqën njëkohësisht edhe në atmosferën specifike të "Atenasve polake". Libri i priftit profesor Stanisław Cielak, ashtu si edhe përkthimi i veprave të Marcin Czermiński-t në gjuhën shqipe, hap perspektiva të reja kërkimore për të dy popujt tanë, të cilët ndonëse larg gjeografikisht nga njëri tjetri, nuk i ndërprejnë kontaktet midis tyre, rrënjët e të cilave i kanë që nga shekulli XIV dhe luftës së përbashkët kundër Turqisë Osmane.

\*Përkthet: Leonard Zissi

## Referencat:

1. M. Czermiński, Shqipëria. Përkthime historike, etnografike, kulturore dhe fetare. Tiranë 2014;
2. L. Zissi, Dokumentet e panjohura për Ndre Mjedën. "Gazeta Shqiptare", 2.VIII.2017, <http://www.g.sh.al/2017/08/02/dokumentet-e-panjohura-per-ndre-mjedes/>[data 12 i 2019].
3. R. Elsie, A Biographical Dictionary of Albanian History, I.B. Tauris 2013, faqe 315.
4. F. Trix, Alfabeti i Stambollit i Shemëdin Sami Beut: pararendës i reformës turke të shkronjave, "Përpjekja" 25: 2008, faqe 266.
5. Sh. Islamaj, Ndre Mjeda-mjeshër i gjuhës dhe i stilit, "Gjurmime Albanologjike-Seria e shkencave filologjike" 2011/41-42, faqe 119-132.
6. Në gjuhën shqipe deri tani është botuar vetëm një biografi e Mjedës-sih R. Idriçi, Ndre Mjeda, Tiranë 1980 (botim i dytë i plotësuar në vitin 2017).
7. Autori i Hyrjes është përkthyesi i librit Leonard Zissi, ndërsa Parathënia është përgatitur nga historiani i Kishës-Prifti Dom Nik Ukgjini. Përveç bibliografisë së gjërë, në libër janë publikuar gjithashtu edhe faksimilet më të rëndësishme të dokumenteve kushtuar personazhit kryesor.
8. Në biogramat e paraqitur në libër, përveç emrit të Ndre Mjedës del edhe emri i një personi tjetër, i cili më pas u lidh me Shqipërinë - Antonio Maria Zannoni (1863-1915), i cili u shuguroi si prift në Krakov nga kardinali A. Dunajewski. Ai vazhdoi veprimtarinë e tij shpirtërore baritore në Shkodër, aty ku botoi edhe gramatikën e gjuhës shqipe.
9. R. Elsie, Albanian Literature: A Short History, I.B. Tauris 2005, faqe 99.

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë dhe e qetë. Shkrimi me argumentin kryesor iu la një traktati të Konstandin Ristanit, një ushtaraku me origjinë shqiptare, që shërben për ushtrinë kanadeze. Një traktat, ku autori bën përqasjen e tij disi akademike dhe shumë ex-cathedra për situatën në Shqipëri. "Forcat politike ligjërojnë me konsensus funksionet shtetërore që emërohen prej qeverisë të tyre por që dalin jashtë kontrollit të qeverisë fill pasi bëhet emërimi dhe nuk preken dot, veçse në rastet e parashikuara me ligj. Shembulli më tipik i kësaj kategorie janë gjykatësit por jo prokurorët. Për të përcaktuar një pozicion të tillë në një shtet ligjor dhe modern ka procedura dhe konsiderata të caktuara të cilat nuk janë objekt analize i këtij shkrimi", shkruan diku ai. Autori ishte shumë i pezmtuar me vonesën e botimit të shkrimit. Duhet të shtojmë edhe një element: Në zgjedhjet e fundit, autori mëtoi të vendoste kandidaturën për president të vendit, paqsa se Kushtetuta e vendit nuk ia lejonte për shkak të kohë-jetesës së shumë jashë vendit. Ndue Dedaj kishte sjellë një tregim shumë interesant me titull "Borizani": Një tregim, që sipas redaktorit duke i hequr pjesën e vockël të paragjykitimit, mbetet i këndshëm. Dy përktues të njohur kishin bashkëpunuar për të na sjellë një cikël poezish të Pier Paolo Pasolinit. Aida Bare dhe Elton Qesari, me këtë përktim, mendojnë se u kanë ofruar të rinjë shqiptarë shembullin e intelektualit të angazhuar, të një personazhi të përhershëm për pushtetet, që ngrii zërin përshtur kundër kapitalizmit dhe parashikoi rrënimin e shoqërisë së konsumit!!! Gjithsesi, nuk është se Pasolini, flet shumë për të rinjtë, sidomos të sotëm.

Redaktori shtoi një shkrim të titulluar: *Pse arti ynë nuk mundet të zbusë politikën?!* Argumenti i tij ishte se: *Arti ynë nuk e ndihmon vendin sepse kjo do të dukej kur individi do të dinte t'i shërbejë si duhet ushqimit estetik të shoqërisë. Shqipëria (lexo: politikanët) e tregon respektin ndaj artit me egërsinë e saj, por edhe varfërinë e madhe ku e ka lënë artistin e zakonshëm shteti shqiptar. Pakkush e do ushqimin shpirtëror të këtij vendi, atë që frymëzon dhe ndryshon, sepse pakkush do ta ndryshojë realisht Shqipërinë...*, shtoi idenë e vet ai. Piktori "Stefos" Stefan Taçi i botuar tre skica, që autori ishte shumë i tërhequr për botimin e tyre, duke vazhduar në modestinë e tij të zakonshme. Pas një kohe të gjatë, kritikut Josif Papagjoni i lamë hapësirë për një shkrim lidhur me pikturën e Gazmend Lekës, ku autori e ngre gati në apoteozë. E shkruar bukur, por do të kishim nevojë për një trajtim më thejshetë se ku qëndron baza e këtij poeti dhe fama e tij. Grafisti Arben Meksi meriton një tjetër çmim ndërkombëtar në karikaturë, në Konkursin Ndërkombëtar të zhvilluar në Krushevac (Serbi), ku konkurroi me më shumë se 270 karikaturistë dhe ku plot 600 punime nga 48 vende të ndryshme të botës, ishin përballë një jurie shumë të zgjedhur ndërkombëtare. Besojmë se ishte relativisht numër i mirë, por që nuk gjeti hapësirën e duhur në faqet promovuese të GSH. Redaktori mund të punonte më mirë me layout-in.

ESSE

"Në kërkim të këmishës së humbur" po zë vend në botimet e vendit. Janë dhjetë ese nga autori Arian Leka, të cilat janë përmbledhur në një libër, botuar pak kohë më parë. Me një sens të lartë mase dhe me një ironi të këndshme, ai bëhet kronikan i kohës së vet dhe i mjedisit, ku gjendemi, por edhe ku jemi "të dënuar" të ekzistojmë...

# Këmisha e Lekës tregohet me dhjetë ese

NGA BEN ANDONI

Ka qenë zgjidhje e menduar mirë kjo e krijuesit dhe publicistit Arian Leka, që ka grumbulluar në një botim të fundit esetë e tij më të mira. Pavarësisht se kjo është një gjini që e ka lëvruar prej kohësh, qoftë dhe në faqet e "Milosao"-s, nevoja e shkrimtarit për të pasur një qasje me publikun e gjerë mbetet e përhershme dhe disi detyruese moralisht. Dhe, shkrimet për të cilat ai kish mbledhur opinione nga kolegët e tij, tashmë kishin nevojë për një publik më të gjerë.

Arian Leka ka një narracion të qetë, të elaboruar mirë dhe të zgjedhur, kurse sintezat e tij janë rezultat i vëzhgimeve të pareshtura, përditërisë së jetës së vet, leximeve dhe më shumë akoma kryqëzimit të opinioneve nga leximet por edhe kontaktet me shumë nga kolegët e huaj dhe vendas. Leka është një vëzhgues i mprehtë i zhvillimeve por edhe arritjeve më të mira ballkanike dhe e vendos mendimin e tij apo duket sikur e taron në çdo moment me këtë hapësirë mbushur me paradokse dhe që botës i ka sjellë aq andralla.

Por, ndërsa ndodh që në autorin patetik, hasur rëndom, përpjekja është për ta vendosur me forcë qendërsinë ballkanase, Arian Leka e bën të vetën dhe e justifikon, duke e ngacmuar, shpjeguar dhe duke ia bërë paradokset sa më të prektshme, Ballkanit tonë. Tek e fundit, sfida për të njohur Ballkanasin është e lidhur kryekëput me njohjen e paradoksit e tij, që është në qendër të letërsisë së mirë të prodhuar por edhe vëzhgimeve të shumta.


Duket se thënia e Hegelit se Historia na mëson atë se ne nuk mësojmë asgjë nga Historia është e ndërftuar normalisht dhe ti udhëton me autorin me të kaluarën; me përcjelljen e genit të tij, gjyshitin partizan; të atin, marinarin; qytetin e vet dhe imagjinatën mbi Sh-

qipërinë, që rri e plazmuar si një kod, që nuk mund të çkodifikohet lehtë nga antropologët e kështu me radhë.

Kultura e mjaftueshme e ndihmon që faktet dhe ndodhitë e së shkuarës të rrinë të qendëruara në libër dhe të na sjellin në kuptimin e ndodhive të së ardhmes, ku kjo lloj historie që thuret në këtë hapësirë të duket normale në anormalitetin e vet.

Gjithsesi, autori nuk humbet në argumente koti, sepse shpesh të drejton tek vetëdija dhe aty ku autori i kohës sonë duhet të jetë vigjilent. Tek "Shkrimtari i Angazhuar", ai jep qëndrimin e vet për individin që i ngjan atij apo mënyrën sesi ne duhet ta shikojmë kohën tonë. Dhe këshilla e tij është e qartë: intelektualit nuk duhet ta shesë shpirtin, kudo dhe kurdoherë, paqsa se mënyrat janë aq të kamufluara dhe mundësia për të mos u njohur janë të shumta. Jo, nuk duhet. Thjesht. "Ai që duhet të ishte momenti i ndarjes nga turma, bëhet momenti i shndërrimit të shkrimtarit të angazhuar ndaj çështjeve me dobi publike, në shkrimtar mirëfilli politik apo thënë ndryshe, të shkrimtarit të urdhëruar politikisht është se ai qorton butë apo kundërshton me maturi. Ky shkrimtar nuk e kundërshton forcen politike ku bën pjesë apo mbështetet edhe pa qenë anëtar, siç bënte dikur Saramago, për të thënë një nga emrat e shumtë. Në vend të prozës dhe poezive, shkrimtari i angazhuar i realitetit shqiptar shndërrohet në duartrokites, ai implikohet me çdo qëndrim të partisë dhe pranon të jetë hartues fjalimesh, që për ironi, edhe pse të dallueshëm për nga stili, nuk do të mbajnë kurrë autorësinë e vet".

U ndalëm tek kjo esse, që bashkon më shumë problemin e sotëm,



Për librin

Autori nuk humbet në argumente koti, sepse shpesh të drejton tek vetëdija dhe aty ku autori i kohës sonë duhet të jetë vigjilent. Tek "Shkrimtari i Angazhuar", ai jep qëndrimin e vet për individin që i ngjan atij apo mënyrën sesi ne duhet ta shikojmë realisht kohën tonë. Dhe këshilla është e qartë: Intelektuali nuk duhet ta shesë shpirtin, kudo dhe kurdoherë, paqsa se mënyrat janë aq të kamufluara dhe mundësia për të mos u njohur janë të shumta. Jo, nuk duhet. Thjesht.

por një njeri i kujdesshëm mund të shohë realisht kudo probleme, që përcillen. Jo shumë larg, ai flet për heroizmin e kohës sonë, apo e thënë më hapur: heroizmin e kohës tonë, që mungon atëherë kur duhet. "Guximi për të thënë jo thjesht të vërtetën e një pale, por të drejtën e paanshme. Aftësia për të kuptuar se duhet ndenjur jo përkrah, përbri apo përballë një grupi, po për të ndenjur përmbi të gjithë".

Ai vetë mban qëndrim për gjërat që ndodhin në vend dhe këtë e tregon në esenë që i kushtoi teatrit, që e ka titulluar "Teatri si formë ndëshkimi". Ndryshe nga shumë



ekskluziv ballkanas dhe se ballkanasi ka monopolin e barbarisë?!", e pyet Leka lexuesin, edhe atë të huaj, i cili ka pasur mundësi t'i lexojë esetë e autorit në disa prej gjuhëve europiane.

Një veçanti tjetër që duhet të theksohet është edhe gërshetimi i teknikave moderne, që në një farë mënyre e ndihmojnë për të gjetur hapësirën dhe tonalitetin e duhur për të folur përmes shkrimit. Dhe, mënyra sesi e grish lexuesin të intereson sepse edhe digresionet janë të jashtëzakonshme për të parë gjëra, ku e vërteta zhvlefësohet, harresa bren historinë dhe lotët pësojnë rënie në bursë, citon ai poetin polak Tadeusz Rozewicz.

"Milosao" është e nderuar që një pjesë e eseve, botuar në këtë libër, kanë qenë në format parake edhe në faqet e saj, për t'u përpunuar pastaj më vonë, dhe për t'u sjellë për publikun e gjerë. Tashmë i mbetet kritikës më të zgjedhur që të vlerësojë teknikisht esetë por edhe të gjykojë për mesazhet e këtyre eseve dhe kontributin e autorit në këtë gjini.

A

ARGUMENT

Ushtaraku kanadez me origjinë shqiptare, pjesë e strukturave të NATO-s, në këtë shkrim të gjatë, që do të vijojë në disa numra tregon konceptin e tij për një shtet demokratik, si Shqipëria, duke pasur parasysh kushtet e saj. Në formën e një traktati, autori mëton të përcjellë shumë mendim, por mbi të gjitha një koncept të drejtë dhe fair, të vendit të tij, që të jetë pjesë normale e komunitetit demokratik të botës...

# Si duhej të ishin funksionet e Shqipërisë sonë?!

NGA KOSTANDIN RISTANI\*

(Vijon nga numri i kaluar)

Krahasimi i disa nga funksione më kryesore të shtetit shqiptar me funksionet respektive të shtetit modern e ligjor

Sipas mendimit tim, për kushtet, rrethanat, mungesën dhe historinë specifike të zhvillimit të shtetit shqiptar, funksioni ekonomik është më i rëndësishmi. Këtë opinion e mbështes në arsyetimin, përshkrimet dhe analizën e mëposhtme.

Së pari po e filloj nga një vëzhgim, mendim e pohim personal se, historikisht shoqëria dhe shteti shqiptar, që nga krijimi i tij, në çdo vit financiar asnjëherë nuk ka përbulluar plotësisht shpenzimet dhe detyrimet me të ardhurat kombëtare të grumbulluara nga burimet vendit. Kush e kundërshton këtë pohim le të tregojë bilancet e shtetit shqiptar të kontrolluara nga financierë ose organizma financiarë kontrollues me autoritet të besueshëm dhe të pavarur, jashtë strukturave të administratës dhe të kastës drejtuese të shtetit shqiptar. Shteti shqiptar gjithmonë i ka mbështetur shpenzimet pjesërisht mbi borxhe të jashtme, ndihma vëllazërore apo internacionale, ndihma të huaja, "çeçe të bardha", kreditorë/donororë dhe përsëri kredi, borxhe, donacione (lexo: lëmosha), e financime nga struktura të huaja apo organizma e organizata ndërkombëtare (një lexues i mirëinformuar dhe i vëmendshëm e vëzhgon qartë këtu radhitjen sipas etapave të ndryshme që ka kaluar shteti shqiptar).

Pra shteti shqiptar e ka mbështetur historikisht zhvillimin e shoqërisë shqiptare mbi borxhe, ndihma, kredi, hua, donacione (lëmosha) etj. Shpenzimet dhe pagesat detyimore të shtetit asnjëherë dhe për asnjë vit financiar nuk janë mbuluar me të ardhurat kombëtare 100% dhe asnjëherë nuk ka pasur një plan, objektiv dhe angazhim konkret afatgjatë se kur apo në ç'vit shteti do t'i përballojë ato 100%. Kjo është hijja e dyshimit të parë mbi kompetencën, aftësinë, seriozitetin bile edhe atdhetarinë e grupeveve politiko-shoqërore që e kanë drejtuar e drejtojnë shtetin shqiptar.

Nga ana tjetër shteti shqiptar historikisht nuk ka sanksionuar, zbatuar, respektuar dhe mbrojtur të drejtën universale të pronës dhe pronësisë. Shembujt nuk janë objekt i këtij shkrimi sepse duhen mijëra faqe për të përshkruar atë masakrim barbar që shteti shqiptar i ka bërë sistematikisht pronës me përkushtim kusari, brigandit e kriminelit. Po ashtu shteti shqiptar historikisht si në rrafshin kombëtar ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar nuk i ka trajtuar me seriozitet dhe me përkushtim detyrimet kontraktuale që kanë rrjedhur nga marrëdhëniet e shkëmbimit të pranuar nga po ai vetë.

Shteti shqiptar historikisht nuk ka respektuar kontratat dhe nuk ka qenë serioz në shlyerjen e borxheve, kredive dhe huave. Shteti gjithmonë ka parë si rrugëdalje



karshi detyrimeve financiare faljen "vëllazërore" apo të imponuar të detyrimeve ose prishje marrëdhënies me palën financuese kur nuk i ka ardhur sipas okeksit. Opinioni im personal është se propaganda demagogjike, neveritëse dhe e shfrenuar zyrtare shqiptare mbi armiqësinë e jashtme kundrejt vijës politike "të drejtë e parimore" të shtetit shqiptar, ose kundërvënja e shtetit shqiptar ndaj politikave të shteteve të tjera që e furnizonin me burime financimi ose të mirash materiale shtetin shqiptar, është një falsitet e pandershmëri ekstreme. Kjo tendencë ka qenë e pavarur nga ngjyra politike të shtetit shqiptar. Nuk e di se sa është i informuar opinioni publik shqiptar mbi treguesin e besueshmërisë financiare të shtetit shqiptar në botën e biznesit ndërkombëtar që merret me këshillimet e investimeve në vende të ndryshme. Po ashtu edhe mbi treguesin e situatës politike të shoqërisë dhe shtetit shqiptar i matur sipas standardeve ndërkombëtare që masin zhvillimet politike në një vend. Kam bindjen se në vlerat e këtyre treguesve mund të gjendet përgjigja e vërtetë për thithjen e investimeve të bollshme e serioze në Shqipëri. Ç'marrëdhënie ekonomike të qëndrueshme e të besueshme mund të krijojë një shtet me një "biografi" marrëdhëniesh ekonomike e kontraktuale të tilla?

## Qëllimet e këtij shkrimi

Qëllimi i këtij shkrimi analizë është për të treguar këndvështrimin personal dhe të mirëinformuar timin si edhe për të ndihmuar e kontribuar në projektimin e perspektivave të shoqërisë shqiptare për një shtet modern e ligjor - kjo në rast se grupi apo grupet drejtuese të shtetit shqiptar dhe opinioni i emancipuar intelektual-shoqëror e politik shqiptar ka dashamirësinë dhe e sheh me mendje të hapur e pa megalomani e xhelozie mesjetare dhe smirë bizantine këtë vështrim analitik.

istrave ose të Kryeministrit. Qeveria nxjerr akte vendimore vetëm për administratën shtetërore dhe veten e vet që janë të detyrueshme e me jetëgjatësi që kushtëzojnë nga pranimit ose abrogimi nga qeveria pasardhëse.

Në një demokraci me parlament ligjëvënës aktet ligjore të detyrueshme për të gjitha objektet e subjektet e vendit propozohen e aprohen në parlament nga subjekte të caktuara me kushtetutë duke përfshirë si qeverinë ashtu edhe një ministër të veçantë të qeverisë.

Një mangësi thelbësore e procedurave të parlamentit shqiptar është mungesa e mekanizmit të filibuster i cili i jep mundësi pakicës në parlament të rrëzojë një projekt ligj edhe kur shumica ka numrin e votave të mjaftueshme për ta kaluar atë projekt ligj në ligj. Në rrethanat e një të kaluar me qeverisje diktatoriale absolute ky mekanizëm do të krijonte në vite kulturën e një qeverisje të emancipuar dhe jo despotike arbitrare të shumicës. Ky mekanizëm, ndërmjet dy zgjedhjeve parlamentare, ndërton edhe "biografinë" e suksesit ose të dështimit të qeverisjes së forcave politike që përbëjnë shumicën gjatë kësaj periudhe.

Me një vështrim të përciptë dallohet lehtë se në shërbimet ndaj individit dhe antarëve të shoqërisë që e voton dhe e zgjedh, shteti nuk e sheh kurrë veten si palë në kontratën politiko-sociale të lidhur dhe sanksionuar në procesin zgjedhor. Arbitrarizmi qeverisës e korruptiv mbizotëron i pa sfiduar nga ligjet, politikat, direktivat e procedurat përkatëse. Mendësia feudalo-bajraktare, primitivo-patriarkale dhe bizantine e përdorimit dhe funksioneve të shtetit do përkushtim brezash që të ndryshohet dhe të zhduket.

E dyta është se përsëri historikisht asnjë drejtues i shtetit shqiptar, asnjë grup politik apo i ashtuquajtur politik i shoqërisë shqiptare si edhe asnjë klasë drejtuese a grupim politik apo ekonomik (në qoftë se ka ekzistuar ndonjëherë) i shoqërisë shqiptare dhe shtetit shqiptar s'ka shtruar pyetjen më themelore të një shoqërie: Me se do të mbijetojë, do të mbështesë ekzistencën dhe do të përparojë shoqëria dhe shteti që neve kemi marrë përsipër ta drejtojmë? Të gjithë i janë shmangur dhe po i shmangen kësaj pyetje, me qëllim apo nga injoranca politiko-ekonomike ose mungesa e atdhetarisë, kjo është çështje tjetër.

Nga ana tjetër këta drejtues shteti dhe të ashtuquajtur politikane nuk kursejnë aspak me shprehje çoroditëse dhe pa asnjë vlerë praktike për individin e shoqërisë shqiptare, kur tërthorazi në mënyrë hileqare, të papërgjegjshme e të pandershme (për të mos thënë poshtëruese dhe skllavëruese për breza të tërë të shoqërisë shqiptare) trumbetojnë slogane bajtë nga më të ndryshmet si "ndërtim socializmin duke mbajtur në njerën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën", "Shqipëria fener ndriçues për Evropë", "ç'thonë të huajt për Shqipërinë", "ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Evropa", "asociimi dhe antarësimi në BE", "luftë korrupt-



sionit", "thithja e investimeve të huaja", "vetingu" etj. etj. Këto parrulla janë krejtësisht të pamatshme dhe të pakontrollueshme në rast se ato nuk i paraprijnë objektiva ekonomike dhe sociale për subjektet e individin e shoqërisë shqiptare në rradhë të parë dhe pastaj për tërë shoqërinë. Asnjë nga këto parrulla e slogane nuk i ka prurë e nuk po i bie mirëqenien, sigurinë, paqen, qetësinë dhe mbarëvajtjen individit apo subjekteve të shoqërisë shqiptare por, arritja e këtyre cilësive realisht me mund, sakrificat, djersë e përkushtim dhe me tregues të matshëm e çon shtetin shqiptar e shoqërinë shqiptare në Evropë e Perëndim si pika referimi të shkallës së emancipimit të saj.

Shteti shqiptar duhet ta vërë vath në vesh njëherë e përgjithmonë që shoqëria kapitaliste është një nga shoqëritë më racionale dhe më efektive që ka ndërtuar raca njerëzore deri më sot dhe si e tillë nuk të fal asgjë pa interesa të qarta ekonomike kryesisht dhe që nganjëherë çfaqen si interesa politike për naivët dhe mëndeshkurterit, dhe që rrallë herë manifestohen me antarësira, bamirësi e lëmosha të ndryshme. Në rastin e fundit arsyeja e vërtetë është se komunitetit të biznesit ndërkomëtar i kushton ekonomikisht shumë e shumë më tepër të merret me një shtet të falimentuar e dështuar se sa të ndihmojë me donacione (lëmosha) e kredi pa interes, apo me interesa shumë të vogël, shtete si Shqipëria apo të tjera të kësaj kategorie.

Pra, parimi kryesor i solidaritetit kapitalist të zhvilluar perëndimor është "ndihmo veten që të të ndihmoj unë edhe më shumë" dhe në asnjë mënyrë e anasjelltas d. m. th. "më ndihmo ti mua që unë të ndihmoj e të kurruptoj veten me ndihmat e tua përjetësisht". Duke filluar nga çdo individ në çdo shoqëri që nga familja e thjeshtë e deri tek shteti një pyetje themelore shtrohet se ku do të mbështeten të ardhurat për të ndër-tuar jetesën dhe gëzuar atë që duam ose ëndërojmë. Pas kësaj vjen pyetja se cilat janë burimet prej të cilave shoqëria shqiptare do të sigurojë të tashmen, do të ndërtojë të ardhmen e saj dhe do të shlyejë kreditë e borxhet e marra për këtë qëllim? Përgjigja e kësaj pyetje është publikuar dhe afishuar asnjëherë me shifra konkrete nga shteti shqiptar dhe drejtuesit e tij për të mos përmendur pastaj programet e partive politike apo grupimeve të ndryshme politiko-intelektuale. Kush nga këta drejtues të shtetit shqiptar që pretendon dhe aspiron për t'u quajtur udhëheqës ka dhënë një vizion të saktë dhe të pakorrigjueshëm se mbi çfarë burimesh e mbështet zhvillimin e vendit të tij dhe në ç'vit financiar e parashikon dhe projektin Shqipërinë të arrijë vetëfinancimin e plotë vetëm nga prodhimi e të ardhurat prej burimeve kombëtare dhe gjithashtu me kredi e borxhe të shlyera. Ç'reforma dhe ç'plane sociale do të mbështesin të ardhurat nga prodhimi kombëtar pa marrë borxhe dhe kredi? Cili do të jetë niveli i cilësisë së jetesës në Shqipëri dhe me ç'tregues të kapshëm do të matet? Në qoftë se një drejtues shteti nuk i bazon premtimet elektorale vetëm mbi të ardhurat kombëtare atëherë ai ose ajo si edhe grupi që ata përfaqësojnë ka projektuar që në fillim dështimin dhe falimentimin me mashtrim - gjë që sipas mendimit tim po ndodh qysh nga krijimi i shtetit shqiptar.

Së treti eksperienca e historisë botërore ka treguar në raste të rralla se drejtuesit e një shteti modern transformohet në udhëheqës kur brenda veteska të mpleksura me njera tjetrën tri cilësi kryesore: ka një objektiv të qartë dhe të saktë për të ardhmen e shoqërisë që drejton; e ka të qartë vetë, ose nëpërmjet shtabit drejtues që zgjedh për bashkëpunim e këshillim, të gjithë rrugën që do të përshkojë për të arritur këtë objektiv; ka besim të fuqishëm, të papërkulshëm dhe të palëkundshëm se do ta arrijë këtë objektiv. Sipas mendimit tim, të gjithë drejtuesit e shtetit shqiptar të pas Luftës së Dytë Botërore nuk i kanë pasur asnjëherë së bashku këto cilësi.

Së katërti në rast se shoqëria shqiptare



dhe shteti shqiptar ka marrë përsipër që të ndërtojë dhe mbështesë një ekonomi tregu atij i mungon serioziteti dhe përkushtimi me të cilën kjo lloj ekonomie dhe këto lloj marrëdhënesh trajtohen dhe këto lloj marrëdhënesh shtetet e konsoliduara me këtë lloj ekonomie. Shoqëria dhe shteti i ekonomisë së tregut ka dy shtylla bazë mbi të cilat funksionon: marrëdhëniet e pronës dhe marrëdhëniet e shkëmbimit d.m.th. kontraktuale. Këto dy struktura shumë të rëndësishme dhe jetike për shtetin e ekonomisë së tregut trajtohen nga administrata shtetërore akoma me mendësinë leniniste të "pronës së të gjithëve dhe të askujt" ose me mendësinë e pronës së "shtetit" absurd e të padukshëm dhe me pa-përgjegjshmërinë ligjore e të pasankcion-

### Paradokset e shtetit tonë

Në planin administrativ e të shërbimit publik, shteti shqiptar, me gjithë ndryshimet e mëdha politike në vend e rreth e rrotull, akoma funksionon me mendësinë e kohës së diktaturës famëkeqe dmth., shtetarët dhe qeveritarët në mënyrë hierarkike i kuptojnë dhe zbatojnë funksionet e shtetit si vetëm urdhëues, komandues, arbitrar, të plotfuqishëm e të pakontrollueshëm, arrogant dhe abuziv. Vlen të përmendet një fakt absurd urdhëues e administrativ i veprimtarisë së qeverisë shqiptare: qysh pas Luftës së Dytë Botërore e deri më sot qeveria shqiptare vepron me VKM.

uar të kontratës që është trashëguar nga paaftësia komunisto-socialiste. Po të funksionojnë këto dy struktura si duhet s'ka nevojë që shteti shqiptar të lutet për anëtarësim në BE por do të jetë kjo e fundit që do t'i lutet për t'u antarësuar për nga vlerat e shoqërisë e shtetit shqiptar në familjen Evropiane.

Shteti dhe shoqëria shqiptare për nga niveli i shërbimit qytetar, social dhe ekonomik është vetëm i krahasueshëm me shtetet dhe shoqëritë më të korruptuara të Globit. Me këto tregues nuk futemi në BE për të mos folur pastaj për thithje e investime serioze, të fuqishme e afatgjata të kapitalit të huaj. Kush investim i besueshëm vjen në këtë ambient dhe me këtë platformë që ekziston në Shqipëri? Vetëm aventurierët dhe spekulatorët vijnë, të ndërgjegjshëm se ka shumë rreziqe por ama nga ana tjetër përfitojnë nga korrupsioni i stimular po prej tyre në këtë terren jashtëzakonisht pjell-

lor dhe primitiv duke e shndërruar atë (korrupsionin) në një sistem të organizuar që asfikson zhvillimin dhe më vonë shoqërinë deri në dështim e falimentim.

Kjo gjendje e përgjithëshme me prirje shumë regressive dhe pasoja katastrofike jo vetëm që s'mund të eliminohet gjatë një mandati qeverisës, por edhe për 50 vjet është shumë e dyshimtë në se do mund të kufizohet, në rast se nuk fillon nga shteti një nismë strategjike me objektiva, masa e procedura shumë të qarta, të matëshme e të kontrollueshme dhe të mbështetura fuqimisht nga grupet e biznesit, grupet politike që qeverisin, brezi i intelektualëve më të emancipuar të shoqërisë shqiptare kudo qofshin, i politikanëve me pushtet dhe pa pushtet dhe së fundi i qeveritarëve të tan-

fare bukur e qartë në shprehjen kaq shumë të zbatuar nga të gjithë neve: "Një kafë e zezë mban dyzet ditë hatër", që, gjithmonë sipas mendimit tim, do të thotë se favorit shkëmbet me favor. Kjo traditë mendoj se e ka zanafillën nga zakoni fisnik i shoqërisë së herëshme njerëzore të shkëmbimit të dhuratave por u shpërdorua, dhunua dhe abuzua në shkallën më të lartë dhe më të sofistikuar nga ana e pushtetarëve primitivë të regjimit famëkeq diktatorial dhe që u ngrulitën në veset më të ulta të "njeriut të ri" e që fatkeqësisht kjo krijesë eksperimentale e laboratorit monstruoze "komunist" përbën në mënyrë masive kluan e pushtetarëve e politikanëve shqiptarë të periudhës postdiktatoriale të tanishme.

Korrupsioni është fenomeni shoqëror dhe jo individual sepse për çdo akt korruptiv duhet një individ korruptues dhe një individ i gatshëm për t'u korruptuar. Ky fenomen është udhëtar i përhershëm i shoqërisë njerëzore në çdo stad apo orientim politik të saj. Unë pranoj dhe mbroj idenë që natyra njerëzore është e prirur drejt përfitimit personal dhe për të arritur këtë synim përdor të gjitha mjetet e mundshme të pranueshme e të papranueshme (por të fshehtë) nga shoqëria, etika, ligjet, morali dhe bindjet personale. Një shprehje e mençur thotë se "pushteti korrupton dhe pushteti absolut korrupton absolutisht". Një nga premisat fillestare për të mbajtur nën kontroll korrupsionin është jo vetëm zhdukja e pushtetit të pakufizuar të një personi po se po, por edhe të një grupi të caktuar dhe më tej kufizimi i pushtetit të një individi apo grupi në caqet më të mundshme reale duke imponuar procedura kontrolli dhe verifikimi në çdo hap ku ka mundësi abuzimi. Kjo zgjidhet me dëshirë politike në rradhë të parë dhe pastaj me procedura ligjore e udhëzime të formuluar qartë e pa mëdyshe. Argumenti më logjik (për ata që nuk e kanë humbur) për luftimin e këtij fenomeni shumë negativ shoqëror është se edhe individët që duket se përfitojnë direkt nga ky ves, në të vërtetë po të analizohen të gjitha rrethanat afatshkurtra dhe afatgjata, dalin shumë më të humbur, por që kërkon shumë mençuri e guxim për ta kuptuar.

Korrupsioni në shoqëritë e emancipuara është i papranueshëm moralisht dhe i dënueshëm ligjërisht ndërsa në shoqëritë primitive është praktikisht i pamundshëm për ndëshkim ligjor. Ai ka një mbështetje të gjërë morale në ambiente të ngushta bile cilësohet edhe si aftësi tejet shkathtësore e një individi. Përndryshe s'ka se si të shpjegojet që në një shoqëri primitive me tradita tejet patriarkale siç është shoqëria shqiptare, dhe kur shpenzimet e disa individëve tejkalojnë në mënyrë hiperbolike të ardhurat dhe pagesat e deklaruar dhe të mbrojtura me ligj, nuk vihen në pikëpyetje nga anëtarët e tjerë të familjes apo të rrethit të ngushtë familjaro-shoqëror ku ky individ jeton, vepron dhe kontribon, por përkundrazi trumpetohehen me mburrje si aftësi e individit për të qenë super i shkathët, biznesmen i lindur dhe i përkryer dhe zbatues shembullor i praktikës së ekonomisë së tregut. Më befafuesja është kur pothuajse në të gjitha ambientet familjare e shoqërore të ngushta shqiptare rradhiten me mburrje pasuritë "e blera" në forma të patundshme në pjesë të ndryshme të vendit nga "të ardhura" të deklaruar ose të taksuara tejet të pakrahasueshme me vlerën e pronësuar. Të gjitha këto shpjegime janë mijëra vjet larg së vërtetës dhe praktikës së ekonomisë së tregut dhe një shtrëmbërim primitiv e injorant i një për zhvillimeve dhe arritjeve më të ndërlikuara të veprimtarisë së shoqërisë njerëzore që përcaktohet si ekonomi e tregut. Këta ish lakej të djeshëm dhe brohoritë historikë të pronës së përgjithëshme mbi mjetet e prodhimit na paskan zbuluar se ekonomia e tregut është ajo marrëdhënie e përvehtësimit të palligshëm (se për të pamoralëshme as që mund të përmendet) që ia jep si privilegj zyra, funksioni publik, pozi-

→ Vijn nga faqja 17

cioni politik, lidhjet e dyshimita me qarqet e biznesit të paverifikuar e mungesa e transparencës e rreptësisë ligjore, e ndershmërisë qytetare e morale dhe, që fatkeqësisht kanë përkrahjen e besimin e një turme tjetër drejtuesish e mbështetësish primitivë dhe injorantë. Nga pikëpamja filozofike korruptuesi e meriton të korruptuarin plotësisht dhe pa ekuivok, por fatkeqësisht më e madhe është për brezin që vjen pas tyre sepse brezi pasardhës s'ka mundësi që të veprojë në një ambient që e zgjedh siç e do vetë ai dhe të pavarur nga trashëgimia e metastazave korruptive të ngulura thellë në trupin e shoqërisë shqiptare nga brezi parardhës.

Sipas standardeve të shoqërisë së emancipuar e taksapaguese perëndimore dhe të BE, absolutisht dhe pa përjashtim, asnjë person publik aktiv në Shqipëri (dhe të gjithë ata që jetojnë nën një strehë me të) nuk e kalon dot provën e ballafaqimit, krahasimit dhe shpjegimit të të gjitha pasurive të tundshme dhe të pa tundshme si edhe të shpenzimeve e mjeteve me vlera të mëdha që ka në përdorim nga njera anë, me të ardhurat jo vetëm vjetore por edhe dhjetra-vjetore nga ana tjetër. Ky është "vetting" i vërtetë ligjor, i qendrueshëm dhe pjellor për ardhmërinë e shoqërisë shqiptare dhe jo ai që llogotisin me hipokrizi e djallëzi të fshehur këshilltarët e diplomatët e huaj në Shqipëri të mbështetur nga të rekrutuarit e tyre në pushtet. Vërtet e gënjen mendja këta persona publikë aktivë (politikane, qeveritarë dhe personat që jetojnë në një strehë me ta) se po ja hedhin biznesit serioz ndërkomëtar dhe BE-së?

Duke përcaktuar më tej boshllëqet e mangësitë e funksionit ekonomik të shtetit shqiptar mendimi im është se atij i kanë munguar dhe vazhdojnë t'i mungojnë objektivat afatgjatë ekonomike prej nga do të sigurohet mbijetesa, të ardhurat dhe mirëqenia shoqërore. Marrëdhëniet e pronës e të shkëmbimit (kontraktuale) si bazë e garantimit të marrëdhënive ekonomike dhe investuese janë të pagarantuar dhe të pabesueshme në kushtet e krijuara nga shteti shqiptar. Si rezultat i këtyre dy pohimeve të mësipërme të ardhurat dhe shlyerja e detyrimeve të shtetit shqiptar për një kohë shumë, shumë të gjatë mbeten të pacaktuara, në pikpyetje dhe pa të ardhme. Vëllja korrekte dhe pa firo e taksave, si burimi kryesor i të ardhurave të një shteti, rrezikohet seriozisht për shumë vjet, për të mos thënë dekada, për arsyen e thjeshtë që inventarizimi dhe rregjistrimi rigoroz e i saktë i pronave, objekteve e subjekteve veprues nën juridiksionin e legjislacionin e shtetit shqiptar nuk mund të përballohet sepse s'ka të ardhura kombëtare të projektuara dhe të gatëshme për t'u shpenzuar për këtë domosdoshmëri, nga burimet e veprimtarisë ekonomike në territorin e ushtrimit të këtij legjislacioni. Sipas mendimit tim identifikimi dhe rregjistrimi i objekteve dhe subjekteve të territorit shqiptar është krejtësisht në amulli të plotë dhe si rezultat prona është e pambrujtur në të gjitha nivelet duke filluar që nga individi e pronari më i vogël e mbaruar deri tek prona e grupeve dhe të njësive të mëdha administrative apo ekonomike.

Përsa i përket doganave ato s'mund të konsiderohen në asnjë rrethanë si burim kryesor të ardhurash për një shtet - vetëm taksat e vjelura nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike kanë "pjesën e luanit" në krijimin e të ardhurave të shtetit. Nga ana tjetër strukturat e shtetit shqiptar nuk po e përgatisin psikologjikisht dhe edukojnë realisht hap pas hapi individin dhe anëtarin e shoqërisë shqiptare se shteti i ekonomisë së tregut është shteti i pronës, kontratës dhe taksave për çdo gjë dhe kudo. Shteti i pakorruptuar i ekonomisë së tregut e kontrollon kaq besnikërisht dhe rreptësisht vjeljen e taksave sa që (sa për krahasim)



## Si duhej të ishin funksionet e Shqipërisë sonë?!

punonjësi i sigurimit famëkeq të kohës së diktaturës "komuniste" mund të konsiderohet shumë i butë në krahasim me punonjësin e strukturës organizative të taksave të këtij shtetit dhe, në qoftë se cilidoqoftë tenton t'i shmangët taksave, e provon mbi lëkurën e vet tërë fuqinë vepruese dhe shkatërruese të detyrimit ligjor të këtij shteti.

Përkshkrimi e analiza e mësipërme krahason në realitetin shqiptar, si në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu edhe të tërthortë, disa nga funksionet kryesore të shtetit të paraqitura në pjesën e parë të këtij shkrimi. Kjo analizë në kushtet e shtetit shqiptar kishte për qëllim funksionin ekonomik kryesisht por që s'mund t'i shmangë funksioneve publike dhe sociale për vetë mpleksjen e vartësinë e pashmangëshme e llogjike të shtetit shqiptar: shteti shqiptar nuk ka dhe nuk përmban e tregon objektiva afatgjatë të qarta ekonomike për zhvillimet e vendit, të ardhurat dhe mbijetësinë e shoqërisë shqiptare. Pasoje e rëndë e kësaj mungese është rreziku i fjalimentimit ekonomik dhe i dështimit politik e social.

Shteti shqiptar në pamundësi për të siguruar të ardhura të konsoliduara, pavarësisht nga grupimi politik që e qeveris, nuk mund të përballojë e mbështetësi asnjë shërbim afatgjatë ose program social për publikun shqiptar e cila më mprehtë pasqyrohet në shërbimin shumë të varfër shëndetësor, arësimor, si edhe në të gjitha aspektet e shërbimeve ku publiku ballafaqohet me administratën shtetërore për një dokument, kontratë, proces gjyqësor, mbrojtje e siguri personale, mbrojtje ekonomike, mbrojtje sociale, trajtim dinjitoz publik, mbrojtje si konsumator, kredi, infrastrukturë, rrugë, rrjet inxhinierik, furnizim me burime që konsiderohen jetike dhe të detyrueshme për një shoqëri siç është uji dhe energjia, jurist të besueshëm, punonjës publik korrekt, ambiente publike cilësore, etj.

Po kështu shteti shqiptar pa të ardhura solide e rrjedhëse nuk mund të thithi në administratën e vet publike njerëzit më të talentuar e më me integritet pasi nuk është në gjendje për t'i shpërblyer drejt, kështu krijon kushte për përmesimin e më të paafëve, në rastin më të mirë, dhe të batakajnive të korruptuar në rastin më ekstrem, në shërbimin publik të të gjitha shkallëve. Kjo gjendje i privon shtetarët shqiptarë nga pasja e një këshillimi e mbështetje të vazhdueshme profesionale, krijuese, dinjitoze, të motivuar e të përkushtuar, të zëshme e cilësore, të besueshme e politikisht të pavarur dhe rigoroze. Kjo mungesë krijon kushte për pakënaqësi dhe turbullira sociale të cilat janë të pavarura nga grupimet politike që janë në qeverisje për momentin e caktuar. Periudha post-diktatoriale moniste e tregon qartë këtë rrjedhim e pasojë. Ato

(kushtet) janë mburjtur e pjekur me dekada të tëra nga paafëtesa, aventurizmi, sharlatanizmi, demagogjia, shtrembërimi, mashtrimi e paqartësia ekonomike e shtetarëve të ndryshëm që kanë qeverisur vendin. Në këto kushte as që bëhet fjalë për ndërtimin e një shërbimi publik dinjitoz e të zëshëm pasi atë e ka dhunuar, shtypur, dërmuar e thërmuar vetë shteti shqiptar që në embrion historikisht e sistematikisht me ndërhyrje e lëvizje politike, "parimore", partizane e partiake absurde gjatë gjithë kohës e pa përjashtim sistemesh e forcash politike.

Absurditeti i shtetit shqiptar dhe i qeverisjes pa principe të tij duket fare qartë në rastin kur forcat politike të majta, kur kanë pushtetin, shkatërrojnë vetveten dhe elektoratin që e mbështet singjerisht, duke eliminuar realitetin e pa asnjë kriter mbështetjen ekonomike të të vetmeve programeve sociale që duheshin ruajtur e përkujdesur nga njera anë dhe kur nga ana tjetër, grupet e individët më të brishtë e më të pambrujtur të shoqërisë shqiptare përbezen deri në dhembe nga monopoli i paskrupullit i atyre që mendohet se historikisht janë solidarizuar e kujdesur për ta dhe do të vazhdonin ti mbronin këta individë. Ndërsa e ashtuajtura e djathtë politike vjen në pushtet me premtime elektorale që kanë platformë çuditërisht të majtë deri edhe komuniste (pavarësisht se komunizmin e përmojnë dhe urrejnë si term) siç ishte rasti i rindarjes së tokës, ndarjes së vlerave të krijuara gjatë periudhës së sundimit primitiv të ashtuajtur "komunist" apo lejimi i uzurpimeve e grabitjeve masive të tokave apo pasurive të patundshme pa sistemin e shitblerjes së ekonomisë së tregut.

Mospasja e të ardhurave kryesore nga burimet kombëtare dhe ekonomike të vendit i tkurr dhe i ngurtëson funksionet e shtetit shqiptar në të gjitha veprimtaritë e tij si kundrejt publikut të tij nën juridiksion ashtu edhe në marrëdhëniet me të huajt, huadhënësit e donatorët veçanërisht, dhe të tjerët përgjithësisht. Shtetarët shqiptarë gjithmonë ndodhen në pozita inferiore bisedimi sepse nuk kanë besueshmëri dhe autoritet të mbështetur në perspektiva e projekte ekonomike bindëse të përgjithshme e të hollësishtme afatgjatë e afatshkurta. Në këto rrethana janë të detyruar të pranojnë këshillime e vendime që shpesh mund të mos jenë të favorshme dhe të zbatueshme për kushtet konkrete shqiptare pavarësisht nga suksesi i propaganduar me aq passion nga partneri huadhënës, donator ose përfaqësues i huaj. Këta shtetarë nuk kanë parasysh sa edhe ai që merr borxh e hua ka të drejtë që të negociojë me dinjitet e profesionalizëm kushtet dhe situatat konkrete dhe aspak të përulët para autoritetit të huaj negociator. Përfaqësuesit shqiptar i është eliminuar ky variant i ndërtimit të bisedimeve pasi vetë shteti i tij e ka asgjësuar me kohë këtë mënyrë bisedimi në favor të përfitimit personal.

Lista e boshllëqeve dhe mangësive mund të shtrihet pa fund në funksionet e shtetit shqiptar por qëllimi i kësaj pjesë të shkrimit nuk është për të zbuluar dhe analizuar në mënyrë të fundme të gjitha boshllëqet e mangësitë e funksioneve të shtetit shqiptar - kjo gjë është e pamundur në një shkrim analitik të kësaj natyre. Përkundrazi, qëllimi këtu është për të zgjuar interesin e lexuesit për shkallën e madhe të ndërvartësisë së funksioneve të shtetit shqiptar dhe pasojat tronditëse që ajo ka në aspektet më kryesore të veprimtarisë së çdo individi dhe grupi të shoqërisë shqiptare.

Në përfundim kjo pjesë e këtij shkrimi analizoi gjendjen e funksioneve të shtetit shqiptar dhe boshllëqet e mangësitë e vëzhguara në krahasim me po të njëjtat funksione të një shteti modern e ligjor ashtu siç është perceptuar e njohur drejtpërdrejt nga eksperianca ime vetiake dhe e pa shtrembëruar. Vijn

P

POEZI

Autori rivjen në faqet e "Milosao" me këtë cikël, ku shpreh gjendjen e këtij momenti në shoqërinë tonë dhe boshësinë e përgjithshme...



NGA ILIR KALEMAJ

### NË PIJETOREN E ËNDRRAVE TË PAREALIZUARA

Në pijetoren e ëndrrave të parealizuar Gotat kthehen, pa u dehur, N'z grip të ekzstencës së pafat, Symbyllazi, Vërdallisei, Në kërkim të eliksirit të jetës.

Nuk na ndihmon as filozofia Zen, as meditimi transhedral, as braktisja pa kthim e së shkuarës, as mungesa e vramendjes për të ardhmen që gjithësi vjen e dyzuar, e turbullt në ujërat e paqartësisë.

Ajo që na shpëton është veç dashuria, arratisja nga mbytja e përditshmërisë, përjetimi i përjetësisë në një çast të vetëm, burimi i pashtershëm i lumturisë.

### KOHË E PAKOHË

Në shumëngjyshmërinë pranverore të syve të saj dallova qashtërsinë e ndjenjës pa dashuri dhe minutat ku e shihja pa e vështruar, dukeshin si orë shekullore... ..humbur në horizontet e trishtshme pa kufi.

Parfumi që la pas në kohë ende ndjehet në gishtërinjtë e mi, në ata sy u përhumba, vdiqa por kujtim i përjetësisë në një çast të vetëm. Në kohën pa kohë ku heshiturazi baresim momentet kristalore dikur të jetuara janë ato që s'na lënë të vdesim.

### MUNGESË

Dhimbja është një hon pa fund, relative në kohë, kështu është dhe kënaqësia, pasionet, frikërat,

ndjesitë, emocionet.

Jetojmë në një planet të çmendur, të mbyllur në mizërinë që na rrethon, frymëjmë pa ajër, nën shkëlqimin e verbër që rrethon. Mungon leva e Arkimedit, sikur të mos ekzistonte kurrë, spiranca e shpresës ku kapen të marrët..., apo ndoshta ëndërrimtarët,

një zemër e dhembshur që do thyente çdo mur. Mungon njerëzoria, empatia, daravitet tej besimi, rrudhet liria, mbliidhemi në guackën tonë, ndërsa tretet në eter dashuria. Për ideal nderoni veç lekun, për Perëndi keni lakminë,

lirikat që frymëzohen tek sheh lulet në maj, harmonia që gjendet tek shpirti i universit që shpërfaqet magjishëm tej në skaj.

### THJESHT FRYMORË

Zullumqarë dhe pehlivanë, shkërdhatokratë dhe rruftanë, brekëgrisor u gdhite dhe ngrysur teveqelë, as moral nuk keni, keni ngelur veç legenë. Për ideal nderoni veç lekun, për Perëndi keni lakminë, parimet i ndërroni sakaq me pushtetin, nuk e njihni as për emër- lirinë! Legëndisur faqe botës, pa dinjitet katandisur, frymorë pa pasojë në Univers, të nisur por të pabitisur. Momentum Raindrops in the corner of the eye, nostalgia for an uncoming time, feeling of a loss that did not occur, you are not gone, but neither are you mine.

R

REVIEW

Autorja bën një analizë të romanit "Nilkon". Romani është i mbushur me qytete dhe perceptime unike, që vijnë prej secilit prej tyre. Gjetja më interesante e autorit është ajo e shpirtëzimit të qytetit, sikur të ishte një njeri me ndjesitë e veta, me gjendjet e humorit - shprehet ajo.

## Romani, si dëshmi e forcës përbashkuese të artit

NGA PROF. AS. DR. MONIKA HASANI

Romani i Fate Velaj, "Nilkon" është një rrëfim mbresëlënës në vetën e parë, ku autobiografia mbushet me rrethana tejet interesante nga vendet ku autori udhëton, ravimimet e piktorit në kërkim të frymëzimit, por edhe të njohjes së botës dhe vetes. Romani autobiografik qëndron mes dy zhanreve, duke marrë më të mirën prej tyre, prej romanit ai ka stilin, rrëfimin e gjatë, arkitekturën e tekstit, kompozicionin dhe syzhetin; prej autobiografisë ai ka Faten (dhe fatin) që si artist, rrëfen nga një pozicion mjaft i afërt ngjarjen e mbushur me detaje, rrethana, fakte reale nga jeta e tij. Çfarë e bën të veçantë një autobiografi? Natyrisht perspektiva e rrëfimit, i cili duke qenë brenda ngjarjeve, na përshkruan me besnikëri, singeritet dhe pasuri të pazakontë detajesh çdo skenë të përfshirë në roman. Duke u bashkuar me unën që rrëfen në vetën e parë, për ne si receptues bëhet shumë e gjallë dhe e prekshme çdo skenë. Për lexuesin përjetimi bëhet gjithnjë e më i fortë prej rrëfimit në vetën e parë, që e trajton ngjarjen si diçka tepër të afërt, si një bisedë mbi rrugëtimin e artistit nëpër botë.

Fati i artistit të arteve figurative, pra i piktorit dhe i fotografit, është krejt i ndryshëm prej atij të artit të shkruarit, pasi gjuha e imazhit është universale, ndaj piktura e tij përcjell në formë emocione të ndryshme, madje mund të themi qartësisht se në të ka edhe kontekst kulturor dhe antropologjik, në rast se do t'i besonim faktit se artisti sublimon në artë realitetet konkrete në të cilat haset. Vendosja e veprave artistike në kontekst, përforon kuptimin e tyre fillestar, por udhëtimi i tyre nëpër galeri të vendeve të ndryshme të botës, është shprehja me e lartë e ndërkomunikimit kulturor, përmes gjuhës universale të artit. Bota e kësaj piktore, përmes shumë përshkrimeve, del tepër e qartë. Por autori dhe njëherësh rrëfimtari i romanit, nuk flet shumë për vetë pikturën e tij, ai në lidhje me të merr një rol disi më të distancuar; si për të lënë të tjerët të gjykojnë për të. Më shumë ai nalet në rrugëtimin e veprave të tij, që herë pas here shihen prej të tjerëve si "kufia", apo në formën e ekspozitave nëpër qytete nga më të ndryshmet. Arti udhëton, çon pak Shqipëri, etnografi dhe antropologji kudo ku shkon, merr nga çdo vend ku shkon, duke sendërtuar përvojat e pasura të artistit.

Romani është i mbushur me qytete dhe perceptime unike që vijnë prej secilit prej tyre. Gjetja më interesante e autorit është ajo e shpirtëzimit të qytetit, sikur të ishte një njeri me ndjesitë e veta, me gjendjet e humorit. Një personifikim kaq i gjallë, që përmbledh shpirtin e qyteteve në përshkrime mjaft lakonike, plot detaje mbresëlënëse dhe kuptimplota. I tillë është një prej përshkrimeve të Vienës, në kapitullin e njëzetë. "Viena nuk ankohej më nga dhimbjet e reumatizmit. Qytetin, që deri përpara pak kohëve e kishte mbërthyer dhembja, tashmë, nën diellin pranveror, e shihje të ecte me atë elegancën e tij aristokratike, me etë ndricimin e tij vezullues, përplasur fort fasadave të godinave, skulpturave në parqet plot lule, kravatave të zotërinjve..." Imazhet janë vizualizime që veç një piktor dhe fotograf mund t'i shndërronë në fjalë, gjithçka merr trajtë, fjala bëhet një magjik përmes të cilit lexuesi përjetojnë imazhe. Janë imazhe të forta, ku qyteti aristokratik dhe elegant i Vienës, ku kryeqytet kulture, përcjell përtej kohërave shpirtin e tij.

Qasja e njohjes së qytetit përmes komportimit të tij me artin dhe produktin artistik, është mbresëlënëse. Përmes saj, rrëfimtari njëqytetin, Ballkanin, por edhe veten. Kështu ndodh përshëmbull tekta burokracia dhe parazitizmi tipik lindor del në pah në mes të Shkupit. "Shtrëbëroi buzëz dhe, duke mërmëritur Viena, Viena, Viena, u fut përsëri brenda me dokumen-



tet dhe pasaportën në dorë, ku mbas një kohe të gjatë humbur zyrave, që më la përshpjetjen se vazhdonte të pinte kafë, u kthye përsëri me dikë, i cili, nga rrudhat e fytyrës dhe struktura e flokëve, më la përshpjetjen se ishte shqiptar. - A prej Shqipnie jeni? - Po, por vij nga Viena. - Çfarë keni futur në arke? - Piktura." Konkretësia me të cilën paraqitet një mentalitet i tërë, komportimi i ballkanasit kundrejt artit dhe artistit, jepet pa stërholime teorike, por përmes situatave të tilla të gjalla, që i japin veprës edhe një ton argëtues, që mëson duke luajtur edhe me humorin. Përplasia e kulturave të ndryshme është poaq e rëndësishme sa duhet nënvizuar në këtë prozë autobiografike, e cila siç duket, kalon kufijtë e personalës, bëhet pasqyrë e kohës së saj, merr tiparet e përjetshme të marrëdhënieve të artistit me kohën e tij, njerëzit dhe publikun.

Përshkrimet ikonike të Vienës, vijnë me pamje nga Shkupi, Gostivari dhe së fundmi Vlorë, qyteti i parë, më i rëndësishmi, arketipi i qyteteve për artistin. Vlorë mbart ngjyrat më subjektive në përshkrimin e saj, nuk ka asnjë ndjesi inferioriteti apo superioriteti të kulturës tënde mbi atë të tjetrit, por Vlorë vjen me natyrshmërinë e personalës, intime, qytetit tënd, qytetit të parë, poaq të rëndësishëm sa dashuria e parë, malli i parë, vera e parë, deti i parë. Romani ka edhe disa tipare të romanit të udhëtimin, brenda lojës me biografinë dhe nxitur prej këtij tipari, në ndalimi dhe analizime edhe tiparin e romanit në udhëtim, ku vendet zbulohen përmes përshpjetjeve të udhëtarit, të përjetimeve të tij, që mund të jenë subjektive herë pas here. "Me të dalë në qafën e ullinjve në Bestrovë u shfaq Vlorë. Ndalova makinën dhe dola jashtë. Fillova ta fotografoja. Një e kuqerremtë e ngrohtë, që vinte nga dielli që po perëndonte mbi Sazan, godiste qytetin. Më ishte bërë si ritual, që sa herë vija këtu, do nxirrja aparatin fotografik nga çanta."

Nili dhe Egjipti, vijnë të pandarë, si nga fillimet e qytetërimit botëror. Edhe pse mes mermertit, pallateve luksoze dhe veshjeve të shtrënjta, narratori këto i shërbëjnë si sfond në të cilin ai ndërton mesazhin e tij më të rëndësishëm. Fytyrat ovale të grave, të bëjnë përshpjetje edhe si lexues, mbeten të pashlyeshme nga kujtesa, ky tipar i përshërtur bashkë me diskutimet mbi mbulesën. Por, çka kulmon në këtë pjesë, është mesazhi më i rëndësishëm i romanit, një mesazh ky që tregon natyrën e fortë qytetare dhe rolin e pashlyeshëm të artit në mbarevajtjen me tjetrin, me të huajin, i cili pasi njihet me artin dhe kulturën tënde, bëhet i afërt, nuk mbetet më i huaj, i largët dhe i pakuptuar. Kjo është forca e pashlyer e artit. Në mënyrë simbolike, kjo vjen përmes lumenjve, Danubit dhe Nilit. "Sapo më erdhi kërkesa nga ministria, e pranova hapjen e kësaj ekspozite. Ideja e dialogut të kulturave, veçanërisht ajo e transmetimit të tyre si në lashtësi, me anën e lumenjve, ma fitoi zemrën edhe më shumë, nga fakti se bëhej fjalë për dy lumenj nga më të bukurit dhe të famshmit e globit, Danubin dhe Nilin."

# R

REVIEW

"Secili çmendet sipas mënyrës së vet", i përbërë nga tri vëllime, është një roman autobiografik që paraqet jetën e autorit Stefan Çapaliku dhe jetën e të tjerëve, nga perspektiva e autorit. Nëse në vëllimin e parë të romanit, ngjarjet lidhen gjithmonë me jetën e autorit (siç e kërkon autobiografia) dhe me vendlindjen e tij, Shkodrën, në vëllimin e dytë ngjarjet zhvendosen edhe në Tiranë dhe në zona të tjera të Shqipërisë, ndërsa në vëllimin e tretë nuk zgjerohet vetëm hapësira gjeografike (që del edhe jashtë kufijve të Shqipërisë), por autori i kapërcen kufijtë e rrëfimit autobiografik, duke ia lënë "privilegjin" e të rrëfyerit një narratori heterodiegetik, që rrëfen historinë e personazheve të tjera, duke i dhënë veprës edhe statusin fiksional.

## Një roman mbi lirinë kaotike

NGA ORJELA STAFASANI

...Vëllimi i tretë i romanit "Secili çmendet sipas mënyrës së vet" është një rrëfim për Shqipërinë e postkomunizmit e deri në vitin 1997, vit kur shpërtheu edhe lufta civile në Shqipëri. I ndarë në tri pjesë, ky vëllim, më shumë sesa rrëfim subjektiv mbi jetën e Stefan Çapaliku, është rrëfim objektiv mbi lirinë e keqkuptuar të shqiptarëve, pas rënies së komunizmit.

### NJË MODEL AUTOBIOGRAFIK

Stefan Çapaliku në vëllimin e tretë të romanit "Secili çmendet sipas mënyrës së vet", për dallim nga dy vëllimet e para, nuk preokupohet për teoritë e ndryshme që e përjashtojnë fiksonin nga autobiografia, as për narratologjinë, që e përcakton se në rrëfimin autobiografik duhet të rrëjëjë vetëm narratori autodiegetik dhe homodiegetik, duke inkorporuar kështu edhe narratoren heterodiegetik.

Rrëfimi i pjesës së parë nis në vetën e tretë me një narratori heterodiegetik që rrëfen historinë e Vaso Thanasit, histori kjo që supozohet se narratori i është rrëfyer nga dikush tjetër. E njëjta gjë ndodh edhe me pjesën e dytë dhe me pjesën e tretë të romanit, ku autori Stefan Çapaliku distancohet nga rrëfimi autobiografik dhe i përdor këto inserte si prezantim i asaj çka ndodhi në Shqipërinë postkomuniste. Pra, historia e Vaso Thanasit dhe Marketin Saraçit, nuk janë histori në të cilat autori merr pjesë, prandaj edhe vendin e narratoriit auto/homodiegetik, ia liron narratoriit të gjithëdijshëm, që pavarësisht mospranisë, e ka të drejtën ta rrëjëjë ngjarjen.

Pjesa tjetër e rrëfimit, përveç stilit reflektiv që merr autori në ndarjen e nëntë të pjesës së tretë, është rrëfim autobiografik i jetës së tij, i motivuar edhe nga pozicionimi i narratoriit që rrëfen në vetën e parë. Se ky rrëfim është autobiografik dëshmohej jo vetëm nga paraqitja e autorit me emër dhe mbiemër, por edhe nga përfshirja e familjarëve të tij, me emra realë dhe përfshirja e personazheve/njerëzve të njohur të kulturës shqiptare, si: Gjon Shllaku, Zef Zorba, Frederik Rreshpja, Primo Shllaku, Ardian Marashi etj, por edhe nga deklaratimet e autorit nëpër epitekte publike, për vërtetësinë e këtij rrëfimi.

Vëllimi i tretë paraqet martesën e autorit, lindjen e fëmijëve, punën si mësues, punën si profesor, specializimin e tij në Itali, nisjen e doktoratës në Shqipëri dhe



shumë episode të tjera të motivuara nga zhvillimet sociale, që gjithmonë jepen përmes një stili ironizues.

Ky është një rrëfim, që vjen si ndërthurje e autobiografisë (në rastet kur jepet jeta e autorit dhe të vërteta tashmë të ditura) dhe e fiksonit (në rastet kur jepet historia e të tjerëve dhe ndryshohen emrat e personazheve Vaso Thanasi, Marketin Saraçi, Ana B etj.). Prishja e kufijve të tillë në roman nuk i përmbahet teorisë së Philippe Lejeune-it që përjashton çdo lloj fiksonaliteti nga rrëfimi autobiografik dhe, kështu, sjell një model të ri shkrimi në letërsinë shqipe.

### FREEDOM DOESN'T WORK

Duke qenë roman autobiografik, "Secili çmendet sipas mënyrës së vet" është i priv-

uar nga një temë bosht dhe përmes mbamendes së autorit prezantohen personazhet, vendet, situatat dhe ngjarjet, sipas një rendi kronologjik. Shembja e diktaturës dhe ardhja e demokracisë, më shumë sesa si dëshmi, vijnë si filtrim ironik i shkrimtarit, që nuk preokupohet për çështjet politike, aq sa preokupohet për mënyrën sesi e priten këtë ndërrim njerëzit. Prandaj edhe përfundimi i vëllimit të dytë të romanit, me fjalët: "Pjesa e tretë ose Sistemi ndërroi si të ishte një fletë libri, të cilën po e la të bardhë, për ta mbushë ata, që e dinë sesi ndodhi..." dhe fillimi i vëllimit të tretë me historinë tragjokomike të shtëpisë së "Zhdukur" të Vaso Thanasit, përmes figurës së elipsës shmangin teprimet që prodhon diskursi i dokumentaritetit dhe japin më së miri gjendjen e mjereshme që

u prodhua pas shembjes së një sistemi të mjerueshëm.

Për dallim nga dy vëllimet e para të këtij romanit, në vëllimin e tretë, historia e Vaso Thanasit, Marketin Saraçit, Aleksit, studentit të letërsisë që shet uthullën e profesorit, etj., bëhen përcaktuese për një rrëfim parabolik që tregon pikat kyçe të historisë së Shqipërisë pas viteve '90: ardhja e një lirie të keqkuptuar, kaosi politik dhe shoqëror, sistemi piramidial dhe shpërthimi i luftës civile, që vjen si pasojë e tri të parave.

Nisja e vëllimit të tretë me shënimin "Pjesa e parë, ose Freedom works", moto kjo që përsëritet vazhdimisht nga Vaso Thanasi, profesori që nisat bashkë me gruan drejt shtëpisë së re në Tiranë dhe mosgjetja e shtëpisë, prodhojnë një situatë komike, por edhe tragjike për të ardhmen e këtij personazhi.

"O ti shok, a zotëri, a çfarë je, ku është ai pallati me kontribut vullnetar i universitetit të Tiranës, se nuk po e gjejmë dot?"

- Ja more burrë ku e ke, para syve. A s'e sheh?

- Ku?! - shqeu sytë Vaso.

- Ka qenë, ma mirë me thanë, se tash nuk asht ma, or ti dashamir (...)

- E vodhën, more zotni. Ia vodhën tana tullat."

Pra, e tillë është gjendja e krijuar në liri, demokraci. Situatat tragjokomike vijojnë edhe më tej, kur Vaso Thanasi, pa marrë askund leje për truallin e tij, vendos ta ndërtojë shtëpinë në oborrin e Institutit Albanologjik dhe merr si asistent një student letërsie, i cili si detyrë kryesore nuk ka studimin e letërsisë, por vjeljen e rrushit në oborrin e Thanasit dhe fermentimin e verës. Historia e studentit të letërsisë,

Landit, të cilit rrushi, në vend që t'i bëhej verë, i është bërë uthull dhe përpjekjet për ta shitur e më pas afrimi i tij të grumbulli me njerëz, ku trumbetohej se sot mund të investojë pak para dhe nesër të merrje dyfishin, çojnë kah elipsa e dytë e përdorur nga autori, që dëshmon ardhjen e sistemit piramidial në Shqipëri.

Zhënjëmi i radhës nga kjo liri shfaqet në historinë e Marketin Saraçit, i cili pas përpjekjeve të shumta për të shkuar në Itali, përfundon në Amerikë, ku asgjë nuk është siç e kishte paramenduar, dhe detyrohet të kthehet sërish në Shkodër.

Rrëfimi nuk ndalet me kaq, por shpërfaq edhe problemet në arsim, ku mësuesit duhet t'i mbledhin nxënësit për të nisur mësimin, shpërfaq problemin e ngujimit si pasojë e shtypjes së deleve nga shoferi i trenit, veprim ky që e legjitimon kanunin, thyerjen e embargos që ishte vendosur me vendet e ish-Jugosllavisë dhe, në fund, përmes një telefonate, shpërthimin e luftës civile.

"Dhe në të vërtetë nuk vonoi shumë dhe në qiellin e plumbtë të qytetit u dëgjuan disa krisma që të kujtonin asgjanë. Krisma fatale. Fishekzjarrë mbi një qiell që nuk kishte kurrfarë nevoje as të skuqej e as të ndriçohej. Ai ishte ashtu i dorëzuar në përhimjen e tij."

Stefan Çapaliku në këtë vëllim, përmes një stili konciz, me fjali të shkurtra dhe shpesh herë me diskurs bisedor, jep të vërtetat e mëdha të shekullit XX, duke u shpëtuar kurtheve dhe animeve politike, dhe duke dëshmuar atë që thotë Sabato, se: "Shkrimtari duhet të jetë dëshmitar i pakorrupsioneshëm i kohës së tij, me kurajë për të thënë të vërtetën, dhe për t'u ngritur kundër çdo autoriteti zyrtar që, i verbuar nga interesat e tij, ka humbur nga sytë shenjtërinë e personit njerëzor. (...) Nëse nuk ndodh kështu, historia e kohëve që do të vijnë do ta ketë krejt të drejtën që ta akuzojë se ka tradhtuar më të çmueshmen e gjendjes njerëzore."

Vëllimi i tretë i romanit "Secili çmendet sipas mënyrës së vet" është jo vetëm pasqyrë e jetës së autorit, por pasqyrë e të gjithë shqiptarëve ku mund ta shohin veten dhe fatkeqësitë që prodhoi izolimi i atdheut, që qe kthyer në një "shpellë që na mbronte nga të tjerët".

Çapaliku, me romanet e tij, por më së shumti me vëllimin e tretë, historinë e jetës së tij e jep si pretekst për të zbuluar historinë e krejt popullit. Motoja "Freedom works" ironikisht na dëshmon se "Freedom doesn't work" dhe se vetëm hapja ndaj botës, mund ta sjellë lirinë e vërtetë.



Opinioni / Ditës

# Rreziku që vjen nga islamofobia

Nga Rigels Lenja

(vijon nga faqja 1)

... SHBA-të u goditën në zemër të tyre nga disa ekstremistë, nga malet e largëta të Afganistanit. Sulme që nuk kishin ndodhur as nga Japonia dhe Gjermania gjatë Luftës së Dytë Botërore. Së dyti, solli një valë në rritje të islamofobisë në mbarë Perëndimin. Myslimanët filluan të shikohen si një kolonë e tretë, e rrezikshme dhe që duhej mbajtur nën survejim.

Pjesë e kësaj vale duhen parë edhe sulmet e ndodhura në Zelandën e Re.

Në përgjithësi, edhe si pasojë e mediatizimit dhe vetëreklamimit, si burim i terrorizmit në kohët moderne, janë parë vetëm islamistët. Por, vrasja e ndodhur në Christchurch tregoi se si terrori i islamistëve, ashtu edhe ai i supermacistëve të bardhë, ka të njëjtën formë dhe pasojë.

Në këto dekadat e fundit ka pasur një mori sulmesh të ndërmara nga organizatat terroriste me natyrë islamike, në drejtim të Perëndimit si në: Londër, Nju Jork, Madrid, Bruksel apo Paris. Kanë qenë vetë myslimanët që janë ndodhur shpeshherë nën të njëjtën valë terrori brenda vendit të tyre. Krimet e kryera nga islamistët në vendet me shumicë myslimane shpeshherë i tejkalojnë në përmasa dhe dhunë, krimet që këta të fundit kanë bërë në Perëndim. Ku mjafton të shikojmë atë se çfarë ka bërë ISIS në Irak dhe Siri.

Synimi kryesor i terrorizmit është të ndajë, "ne" dhe "ata". Vetëm nëpërmjet ndarjes ata mund të fitojnë kredibilitet dhe mbi të gjitha, të mbijetojnë. E veçanta e kësaj masakre vjen prej faktit se akti i vrasjes së 49 besimtarëve myslimanë ndodhte në atë që presupozohet të jetë shtëpia e Zotit dhe e paqes. Por, kjo nuk është një ngjarje e shkëputur nga konteksti. Në vitet e fundit, në disa vende perëndimore ka një rritje të forcave islamofobe, të cilat rëndomte e kanë përdorur gjuhën antiemigracion dhe anti-Islam për arsye populiste. Në së paku tri vende të rëndësishme në Perëndim, kjo është kthyer në doktrinë. Në SHBA pak ditë mbas inaugurimit, Presidenti Trump vendosi ndalimin e hyrjes në SHBA për shtetasit e së paku 5 vendeve me shumicë myslimane. Ndërsa pak ditë më parë u shpreh se do të kërkonte ndalimin e plotë të hyrjes së çdo personi që i përkihte besimit islam. Në Europë, ministri i Brendshëm i Italisë, Salvini, i quan emigrantët që vijnë nga bota islame si rreziku më i madh që i kanoset Europës. Megjithatë, Salvini harron që shkak i asaj që po ndodh sot vendet e botës islamike është edhe pasojë direkte e



politikave kolonializuese, pjesë e të cilave ishte edhe Italia. Pa harruar edhe më të rëndësishmin Viktor Orban e Hungarisë, në sytë e të cilit, myslimanët janë duke nxitur një krëqëzatë në Europë. Orban do të mbahet mend si kryeministri që i risolli në kujtesë Europës ndarjen me mure. Orban e ka kthyer antiislamizmin në një nga kuajt e tij të betejës në çdo proces zgjedhor. Madje, ka arritur sa edhe ta shpallë veten mbrojtës të Perëndimit të Krishterë, një titull i denjë për mbretërit dhe perandorët e periudhës së Mesjetës.

Përfituesit më të mëdhenj të kësaj konjunkturë janë supermacistët e bardhë në njërin kah dhe

organizatat terroriste islamike në kahun tjetër, si ISIS apo Al-Kaeda. Këto të fundit do të kenë në duar tashmë një kartë të rëndësishme për të luajtur. Atë të shpalljes se vetëm ata mund t'i mbrojnë myslimanët.

### FAKTORI INTERNET

Teknologjia është sot më shumë se kurrë, pjesë e jetës së çdo njeriu. Me gjithë të mirat që ka sjellë, ka krijuar edhe një mori problemesh. Ndër të cilat edhe lehtësia për t'u vënë në kontakte me materiale, dokumente apo të dhëna që nxisin gjuhën e urrejtjes. Vrasjet e ndodhura në Zelandën e Re kishin edhe një anë tjetër negative, vrasësi e transmetoi të gjithë masakrën në një video

"live" në profilin e tij, në "Facebook". Kjo krijon një precedent të rrezikshëm, i cili mund të ndiqet nga të tjerët. Ky grup individësh, të cilët marrin përsipër të kryejnë këto veprime, zakonisht vuan nga probleme mendore, ose kanë një dëshirë për t'u vënë në qendër të vëmendjes. Ishin pikërisht këto platforma sociale, me anë të të cilave ISIS arriti të rekrutojë më shumë se 70% të militantëve të saj. Këta precedentë kanë çuar në një mori pyetjesh rreth mënyrës si funksionojnë rrjetet sociale. Një çështje që duket e vështirë për t'u gjetur një zgjidhje.

Të jesh sot islamofob do të thotë të urresh pa arsye gati ¼ e popullsisë botërore. Duhet pranuar që sot Islami ka një problem se si mund të reformohet. Por, nëse shihet në shifra, ekstremistët dhe radikalët janë të paktë në numër, të papërfillshëm krahasuar me 1.3 bilionë myslimanët që jetojnë sot në botë.

**\*Rigels Lenja, studiues, pranë Universitetit Ludwig Maximilian në Mynih.**

Në përgjithësi, edhe si pasojë e mediatizimit dhe vetëreklamimit, si burim i terrorizmit në kohët moderne, janë parë vetëm islamistët. Por, vrasja e ndodhur në Christchurch tregoi se si terrori i islamistëve, ashtu edhe ai i supermacistëve të bardhë, ka të njëjtën formë dhe pasojë.

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje kanë të gjitha shanset për të kaluar një të diel të rehatshme. Do të keni kohë mjaftueshëm për të realizuar planet tuaja. Gjithashtu, do të keni mundësi të mbledhëni me miqtë, ose të ushtroni hobin tuaj.

### DEMI

Mos bëni kritika të shumta kundër personave të afërt, pasi kjo nuk do të ndikojë aspak mirë në gjendjen e tyre emocionale. Mendoni sesi mund ta kaloni sa më mirë këtë, duke kryer aktivitetet që ju dëshironi. Ka gjasa të gjeni një rrugë të re, e cila do t'ju emocionojë pafund.

### BINJAKET

Nuk do të kaloni një ditë argëtuese ashtu sikurse ju do të dëshironit. Më së shumti do të merreni me punët e shtëpisë. Pasditë do të gjeni pak kohë për veten dhe partnerin/partneren tuaj. Bëni shumë kujdes me dietën ushqimore.

### GAFORJA

Është dita e duhur për të marrë pjesë në sporte të ndryshme. Por, mos merri vendime këtë të diel, pasi ka gjasa që të gaboni. Familjarët nuk do të bien dakord njëzëri rreth dëshirave të tyre gjatë ditës së sotme.

### LUANI

Gjatë kësaj të diele do të gjeni kohë mjaftueshëm për t'u relaksuar. Arrija e harmonisë është e mundur, por vetëm nëse i lejoni vetes të harroni problemet e pazgjidhura. Rekomandohet të bëni një shëtitje, e cila do t'ju ndihmojë si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht.

### VIRGJERESHA

17 marsi do të jetë për ju një ditë e mbushur plot energji. Megjithatë, bëni kujdes pasi mund të lothëni më shpejt seç e prisnit dhe mund të mos përfundoni disa detyra të rëndësishme. Është e nevojshme të çliroheni nga presioni i panevojshëm.

### PESHORJA

Peshoret mund të përballen me shumë probleme, të cilat do t'ju sjellin shqetësime gjatë kësaj dite. Ndihma që do t'ju japë një mik i tuaj i ngushtë do t'ju nxjerrë nga situata. Në mbrëmje do të gjeni paksa kohë për t'u relaksuar dhe për të zhvilluar një bisedë të rëndësishme me partnerin/partneren tuaj.

### AKREPI

Është dita e duhur për beqarët e kësaj shenje. Do të jeni në qendër të vëmendjes së seksit të kundërt. Mos humbini shanset për të shkëmbyer kontaktet me dikë që ka shprehur interes ndaj ju.

### SHIGJETARI

Miqë dhe familjarët do përgjigjen t'ju ndihmojnë për të përfunduar disa detyra të rëndësishme. Do të keni shansin të rrisni të ardhurat, pas shities së disa produkteve. Bëni mirë t'i nënshtroheni një diete për rënie në peshë.

### BRICJAPI

Është e rëndësishme t'i jepni vëmendjen e duhur partnerit/partneres dhe t'i shprehni dashurinë pa hezituar. Do të keni fat nëse përfshihen në një projekt të rëndësishëm. Ka gjasa që një mik i tuaj do t'ju kërkojë ndihmë për të çikështur të caktuar.

### UJORI

Mund të zhvilloni një bisedë të çuditshme me një prej të afërmeve tuaj. Rekomandohet të mos kontaktoni me persona që nuk i besoni plotësisht. Mund të organizoni një festë me miqtë tuaj, që ka gjasa t'ju sjellë momente të paharrueshme.

### PESHQIT

Peshqit do të qartësojnë një sërë çështjesh të rëndësishme. Bëni kujdes me fjalët, pasi mund të ofendoni një kolegun tuaj. Gjithashtu, ka gjasa të përfshihen në një konflikt me një prej miqve ose familjarëve.

Opinion

i Ditës

# Rama nuk ra, por u fsheh pas gazit lotsjellës

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... shpërfaqur fytyrën e vërtetë të regjimit të Tiranës.

Si kurrë ndonjëherë në këto gjashtë vite të pushtetit të rilindjes, në rrugët e kryeqytetit nuk ishte parë kaq mbipullim me trupa sigurie dhe kamera spiune, nuk kishin marshuar kaq makina të blinduara dhe nuk ishte përdorur ajo sasi e paimagjinueshme breshërie me ujë dhe gaz lotsjellës.

Po të bësh një krahasim imazhesh me 16 shkurtin e një muaji më parë, uniformat blu nuk genë më ato që u hapnin rrugën protestuesve të inatosur për të kapërcyer shkallët e Kryeministrit, por ato kishin marrë urdhrin e prerë, për të mos u tërhequr asnjë centim nga mbrojtja e pushtetit.

Në fakt, ndryshimi nuk është vetëm në imazh.

Në këto 30 ditë, që nga protesta që i parapriu vendimit të djegies së mandateve, imazhi i një vendi normal demokratik është krisur ndjeshëm.

Parlamenti pothuajse mblidhet



në mënyrë ilegale, pa shpallur as ditën dhe as orën e seancave plenare. Kryeministri është rikthyer të bëjë rolin e shefit të partisë-shtet, që në vend të punëve të përditshme, detyrohet të luajë klounin endacak të grave socialiste. Opozita e re po identifikohet me fytyrat

e heronjve të porsalindur, Ylli Shehu dhe Kujtim Gjuzi. Televizionet kombëtare kanë degraduar në ditët më të zeza të propagandës, ndërkohë që shqiptarëve po u shfaqet si gogol rreziku i armikut të jashtëm, që herë merr formën e ariut rus dhe herë vesh

rrobën e mullahëve iranianë.

Dilema që shtrohet është: A do të që i mundur ky degradim kaq i shpejtë, ky precipitim marramendës, nëse opozita nuk do të kishte vënë bast për rrugën radikale?

Natyrisht, që kjo pyetje retorike

është e vlefshme edhe për këtë 16 mars.

Sepse nuk ka rrugë tjetër veçe mbajtjes nën presion të këtij regjimi që ka promovuar kriminelët në parlament, oligarkët në ekonomi, ndërtuesit me paratë e drogës në Tiranë dhe banditët që vjedhin vota në Durrës apo në Dibër.

Kjo ndodhi edhe këtë të shtunë.

Në rrugët e Tiranës, në mediat vendëse dhe ndërkombëtare, mbetën të skalituara pamjet e tymnajës së një pushteti, që fshihet pas gazit lotsjellës. Tani jemi larg, shumë larg imazhit të liderit shpresëdhënës, që shkulte gardhin e Kryeministrit, që hapte hollin e saj për qytetarët, që i dekoronte oborrin me punime të artistëve bashkëkohorë.

Tani, për të qeverisur, Edi Rama ka nevojë për trupat speciale dhe për rendjen e autoblivandave nëpër bulevard. Kjo është ajo që i shkon për shtat pushtetit të tij.

Dhe në një muaj, opozita e arri-ti këtë.

Ajo i veshi kryeministrit me forcë, kostumin real të autokratit, pavarësisht se nuk ia doli ta rrëzonte këtë 16 mars, ashtu siç u premtoi ithtarëve të saj.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET


KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL
1. Mund të jetë e pasur me minerale.
7. Ascoli në tabela.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premtojnë të bëhen kampionë të tillë.
14. Janë felinë të egër.
16. Marubi i fotografisë.
18. Janë meduza.
19. Një anarkist i famshëm.
21. Smith filozof.
22. Susanna shkrimtare italiane.
23. Shkurt për company.
24. Organizma Autonome Kombëtare.
27. Mbarojnë punime.
28. Ndezur në aparaturë.
29. Bëjnë arte me re.
30. Nduket për gjysmë.
31. Mbyllin fushat.
32. Luca bomber.
34. Emri i parë i Pasolini-t.
35. Një mund të jetë fetar.

- 37. Lidhen të parat.
38. Fundi i një faze.
39. Emri i Bismarck.
40. Kant e Diabolik.
42. Ze... në traget.
44. Ente Informacioni Rajonale.
45. Triolet e Trëndafilë me kredi.
47. Rruga e Ferenc Molnar.
48. Në krye të notarëve.
50. Gjysmë tatimi.
51. Ushtrihet me cd false.


- VERTIKAL
1. Numër i shkurtër.
2. Britame Arkimedit.
3. Inicialet e Paganini-t.
4. Fundi i Turandot.
5. Eshhtë fjetore ushtarësh.
6. Parker regjisor.
7. Kështu quhet që ushqim kundër intoksikimit.
8. Një birrë e jona.
9. Mund të jenë përirimi.
10. Festat pa fat.
11. Qendër ditore.
13. Janë nomadë.
15. Fillojnë atletikën.
16. Eshhtë brinjë në skuadër.
17. Sidney i Serpico.
18. Qe centauri që mësonte Akilin.
20. Në mes të një kanali.
25. Bëhet për zakon.
26. Tregon martesë.
27. Një super... për shopping.
33. Vala e stadiumit.
34. Fillojnë poshtë.
36. Një provë... inteligjence.
38. Vaçe e famshme e këngës tonë.
41. Fillojnë vallen.
42. Para es Salaam.
43. Linearë pa larë.
46. Nota e diapzonit.
47. Mbyllin një shtëpi.
49. I keni në dorë.

Fjalëkryqi (2)

- HORIZONTAL
1. Eshhtë skuadra e donatorëve.
7. Mbyllin një turp.
9. Mund të jetë unik.
11. Një i absurdit ëshhtë i Samuel Beckett.
14. Qyteti i përjetshëm.
15. Interpreton Sandokan.
17. I ka tek tenda.
18. Eshhtë këngëtar lirik.
19. Arturo i Brecht.
20. John, i forti i Sylvester Stallone-s.
21. Françesku kantautor.
22. Eshhtë religjion politeist.
25. Qerre pa qe.
26. Gjysmë alarmi.
27. Eshhtë shtëpi i ZP.


- 30. Kush ka... ka zët.
31. Altini mesfushor.
32. Janë vajzat në atletikë.
34. Eshhtë shpend lagune.
36. Gjysmë thyese.
37. Udhëhoqi Argonautët.
39. Mund të jenë fotografikë të tillë.
40. Fillojnë panikun.

- VERTIKAL
1. Janë çnjerëzore.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Edi në krye të PS.
4. Eshhtë illoj papagalli.
5. Fund turni.




- 6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Para devils për lojtarët e Manchester United.
8. U shkrua nga Kadare.
10. Conan ai i Schwarzenegger.
11. Pak titanike.
12. Arbeni pa çifte.
13. I ka tek treni.
15. Mund të jenë pushimi.
16. Mund të prishej nga je... kleçkë.
18. Në krye të bashkisë.
20. Eshhtë kundërshtar në dashuri.
23. Meta në krye të LSI.
24. I vidhet ustait.
27. Jeppet e Artë në Cannes.
28. Eshhtë pije e jona.
29. Kufizojnë kënde.
31. Fillojnë lehtë.
33. Eshhtë dritëshkurtri.
35. Eshhtë numri i... të parit.
38. Fillojnë nazet.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar


Completed 9x9 Sudoku grid.

Argëtim filozofik

- \*- Kur një njeri të shkakton zemërim, do të thotë se ai është më i fortë se ti.
\*- Jeta është gjithmonë duke pritur kohën e përshtatshme për veprim.
\*- Ndonjëherë jeta i ndan dy njerëz vetëm për të treguar se sa të rëndësishëm janë ata për njëri-tjetrin.
\*- Ajo që ndodh një herë, nuk mund të ndodhë përsëri. Por ajo që ndodh dy herë, patjetër do të ndodhi dhe për së treti.
\*- Të gjithë jetojmë nën të njëjtin qiell, por jo të gjithë kemi të njëjtin horizont.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË KALUAR

Answers to previous crossword puzzles in a grid format.

FJALËKRYQI (1) FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

- \*- Nëse dashuria transformon një person me shpejtësi, dëshpërimi e bën atë edhe më shpejt.
\*- Sapo kam gjetur të gjitha përgjigjet, menjëherë ndryshuan të gjitha pyetjet.
\*- Kurrë nuk e kam bërë gabimin të flas me njerëz mendimet e të cilëve nuk i respektoj.
\*- Tri gjëra e karakterizojnë njeriun e mençur: Së pari, bën ato që këshillon të tjerët të bëjnë. Së dyti, nuk bën asgjë që është në kundërshtim me të vërtetën. Së treti, është i durueshëm me dobësitë e të tjerëve.

